



# **Raporti i Monitorimit në Drejtësi nga Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit**

**Gjetjet dhe rekomandimet  
Shtator 2019 – mesi i muajit mars 2020**

**Tetor 2020**



# **Raporti i Monitorimit në Drejtësi nga Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit**

**Gjetjet dhe rekomandimet  
Shtator 2019 – mesi i muajit mars 2020**

**Tetor 2020**



# PËRMBAJTJA

---

<b>Parathënie</b> .....	5
<b>1.Hyrje</b> .....	7
<b>2.Gjetjet nga monitorimi sistemik</b> .....	8
2.1 Trendi i vazhdueshëm i më pak seancave joproductive .....	8
2.2 Disa përparime në ritmin e gjyqimit të rasteve të profilit të lartë.....	8
2.3 Funkionimi i Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit në Prishtinë .....	10
2.4 Ndjekja e rasteve të terrorizmit.....	11
2.5 Politika për rigjykimet në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovë .....	12
2.6 Caktimi i rasteve në procedurat e rigjyqimit .....	13
2.7 Pyetjet e tërthorta .....	15
2.8 Shpallja e aktgjykimeve për raste penale në shkallë të parë.....	17
2.9 Paraburgimet .....	18
2.10 Konfiskimi dhe konfiskimi i përkohshëm i pasurisë .....	19
<b>3. Gjetjet nga monitorimi tematik</b> .....	21
3.1 Anti-korrupsioni .....	21
3.2 Krimet nga e drejta ndërkombëtare .....	23
3.3 Privatizimi dhe likuidimi .....	25
3.4 Paneli i ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës / të drejtat pronësore .....	26
3.5 Krimet e urrejtjes .....	28
3.6 Dhuna në bazë gjinore .....	30
<b>Shtojca I</b> – Lista me rekomandime .....	33
<b>Shtojca II</b> - Lista e rasteve të monitoruara dhe të referuara .....	37



# PARATHËNIE

Kam nderin që të prezantoj “Raportin nga Monitorimi Sistemik dhe Tematik në Drejtësi” i cili është përgatitur nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë dhe i cili bëhet publik për herë të parë.

Që nga fillimi i vitit 2019, Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit ka prodhuar katër raporte të këtij lloji. Tri raportet e para janë prezantuar vetëm para Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe institucioneve të tjera të Kosovës dhe organizatave ndërkombëtare.

Duke e pasur parasysh rëndësinë e sundimit të ligjit, në veçanti sa i përket procesit të përafrimit të Kosovës me BE-në, tani ka ardhur koha që rezultatet e punës sonë të monitorimit në Policinë e Kosovës, prokurorinë dhe gjyqësorin të vihen më në dispozicion për opinionin e Kosovës, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile për sundim të ligjit të cilat edhe janë të angazhuara në monitorimin e gjyqësorit, avokatët dhe profesionistët e tjerë të fushës juridike, si dhe qytetarët e interesuar.

Ky raport me shpresë do t'i kontribuoj debatit rreth mënyrave për përmirësimin e sundimit të ligjit në Kosovë si dhe përmban një listë me rekomandime specifike. Publikimi i këtij raporti gjithashtu ka për qëllim ngritjen e transparencës rreth punës së Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit në këtë fushë kritike të mandatit të tij aktual për mbështetjen e fuqizimit të sistemit të drejtësisë së vendit, si dhe rreth mënyrës me të cilën Misioni bënë vlerësimin e progresit të shënuar dhe sfidave me të cilat ballafaqohen partnerët tanë të sundimit të ligjit në Kosovë.

Vlerësimi kryhet përmes monitorimit “të thuktë” të rasteve penale dhe civile të zgjedhura, përfshirë raste të profilit të lartë dhe raste të cila janë shqyrtuar nga Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit deri në qershor të vitit 2018, kur përfunduan funksionet e tij ekzekutive në gjyqësor.

Monitorimi i drejtësisë i kryer nga Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit bazohet në dy tipare unike:

E para, Misioni gëzon qasje të plotë në sistemet gjyqësore, prokuroriale dhe policore, e cila është dhenë nga autoritetet e Kosovës në kuadër të mandatit të rishikuar të Misionit të miratuar në qershor 2018. Kjo na e mundëson që të plotësojmë monitorimin e seancave dëgjimore gjyqësore që bëhet bashkë me organizata të tjera ndërkombëtare dhe organizata të specializuara të shoqërisë civile me një rishikim dhe vlerësim “prapa skenave” të mënyrës së shqyrtimit të rasteve specifike para dhe pas seancave gjyqësore.

E dyta, monitorimi i bërë nga Misioni e mbulon tërë sistemin e drejtësisë penale, si dhe aspekte të sistemit të drejtësisë civile, duke u bazuar në punën e ekspertëve tanë nga shtetet anëtare të BE-së, nga fushat e policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit, me homologët e tyre nga Kosova. Në rastin e Prokurorisë Speciale, këta ekspertë monitorues nga BE-ja janë të bashkëvendosur me kolegët e tyre nga Kosova.

Unë shpresoj se përmes prezantimit të këtij raporti para opinionit të gjerë, gjetjet dhe rekomandimet e Misionit do të bëjnë që të kuptohen më mirë gjërat që duhet bërë për drejtësi dhe sistem të sundimit të ligjit në Kosovë më llogaridhënës, efikas dhe të qëndrueshëm, në mënyrë progresive.

Më tej, të qenët më të hapur dhe më të njoftuar me mënyrën e funksionimit të institucioneve themelore të sundimit të ligjit është në interesin më të mirë të popullit të Kosovës, dhe do të ndihmojnë në trasimin e rrugës së Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

**Lars-Gunnar Wigemark**

Shef i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë



# 1. HYRJE

Njësia për Monitorimin e Rasteve (NJMR) e Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX) bënë vlerësimin e funksionimit të Policisë së Kosovës dhe të gjyqësorit për nga aspekti i përputhshmërisë procedurale, ligjore dhe të të drejtave të njeriut. Ai shtrihet nëpër tërë zinxhirin e drejtësisë penale (policia, prokuroritë dhe gjykatat) si dhe në aspekte të sistemit të drejtësisë civile. Ky raport, i katërti me radhë, mbulon periudhën nga shtatori 2019 deri në fillimin e pandemisë së koronavirusit në mes të muajit mars 2020.

Vlerësimi kryhet përmes monitorimit sistemik dhe tematik të rasteve të zgjedhura penale dhe civile, përfshirë raste të profilit të lartë dhe raste që më parë janë shqyrtuar nga EULEX-i deri në qershor 2018. Monitorimi mbulon tërë zinxhirin e sistemit të drejtësisë penale dhe civile, që përfshinë nivelin policor, prokurorial dhe të gjyqësorit.

Pjesa që mbulon monitorimin sistemik fokusohet në çështjet e identifikuar gjatë monitorimit të rasteve individuale të cilat kanë dimension sistemik, pra tregojnë për praninë e mundshme të ndonjë problemi në një shkallë më të gjerë nëpër tërë sistemin. Kjo është arritur përmes monitorimit të proporcionit të seancave dëgjimore produktive, progresit të rasteve të profilit të lartë, funksionimit të institucioneve të specializuara, ndjekjen penale të rasteve të terrorizmit, politikës së rigjytimeve, praktikave të pyetjeve të tërthorta nëpër gjykime, shpalljes së gjykimeve penale, paraburgimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar nga veprimtari kriminale.

Pjesa që mbulon monitorimin tematik identifikon çështjet në bazë të monitorimit të llojeve specifike të rasteve, si krimet e kryera nga urrejtja apo paragjykimet, apo dhuna e bazuar në gjini. Temat tematike të identifikuar janë: korrupsioni, krimet e urrejtjes, dhuna në bazë gjinore, krimet nga e drejta ndërkombëtare, privatizimi dhe likuidimi dhe Paneli i Ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës /të drejtat pronësore.

Këto tema janë identifikuar meqë ato janë relevante për nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe e drejtësisë tranzicionale. Duke u bazuar në gjetjet, rekomandimet kyçe janë dhënë në çdo kapitull dhe një listë me të gjitha rekomandimet është paraqitur gjithashtu në shtojcën I. Shtojca II e këtij raporti përmban një përmbledhje të rasteve të përmendura në këtë raport.

Ky është raporti i katërt nga monitorimi sistemik dhe tematik që është përgatitur nga EULEX-i që nga fillimi i vitit 2019 dhe raporti i parë i cili publikohet për opinionin. Të gjitha raportet e mëparshme janë prezantuar para Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe të gjitha institucionet e tjera vendase dhe organizatat ndërkombëtare relevante. Ato raporte përmbajnë gjetje dhe rekomandime për përmirësime në sistemin e sundimit të ligjit me qëllim të asistimit të institucioneve të drejtësisë të Kosovës për arritjen e përputhshmërisë më të madhe me legjislacionin e Kosovës dhe standardet e të drejtave të njeriut.

EULEX-i gjithashtu përgatitë dhe zbaton projekte të cilat ofrojnë masa të trajnimeve dhe shkëmbime të praktikave më të mira për partnerët vendas me qëllim të trajtimit të zbrazëtirave të identifikuar.



## 2. GJETJET NGA MONITORIMI SISTEMIK

### 2.1 Trendi i vazhdueshëm i më pak seancave joproductive

Seancë dëgjimore joproductive përkufizohet si seancë dëgjimore e cila është caktuar të mbahet por e cila shtyhet menjëherë pas fillimit pa asnjë progres domethënës. Seancat dëgjimore joproductive janë karakteristikë e mosefikasitetit në sistemin e drejtësisë dhe bëjnë që procedurat të tejzgjaten. Zgjatja e tepruar e procedurave mund të jetë burim i mosbarazisë, mund të krijojë kushte të favorshme për zhvillimin e korrupsionit dhe në fund të shpijnë në mungesë të besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Prej 287 rasteve të monitoruara në periudhën gusht 2019 deri shkurt 2020, 67 ishin joproductive (23%), krahasuar me 29% në periudhën e mëparshme të raportimit.

Në dhjetor 2019, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) duke i ndjekur gjetjet nga raportet e mëparshme sistematike dhe tematike të EULEX-it, i udhëzoi të gjitha gjykatat që t'i përcjellin seancat joproductive dhe t'i identifikojnë arsyet kryesore të kësaj dukurie me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështjeje në mënyrë strukturore. Që nga mesi i marsit 2020 kjo çështje ende ishte në proces të adresimit. Arsyeja kryesore pse seancat e monitoruara nga EULEX ishin joproductive ishte mungesa e të pandehurit (36%). Në disa raste kjo ishte për shkak të koordinimit të dobët midis Gjykatës dhe Shërbimit Korrektues. Megjithatë, në shumicën dërrmuese të këtyre çështjeve të pandehurit nuk ishin në paraburgim dhe u thirrën siç duhet por megjithatë nuk u paraqitën në gjykatë. Disa seanca u desh të shtyeshin për shkak se prokurorët, por në një masë më të vogël, edhe gjyqtarët nuk ishin të pranishëm në seanca.

#### Rekomandime:

- Llogaridhënia në drejtim të menaxhimit të gjykatës duhet të rritet;
- Gjyqtarët duhet të raportojnë rregullisht për numrin e seancave joproductive dhe çfarë masash janë ndërmarrë, nëse ka. Nëse nuk janë ndërmarrë masa, ndërsa kjo do të kishte qenë e mundur, duhet të jepet një arsyetim;
- Prokurorët duhet të mbahen përgjegjës nëse ata janë shkak për një seancë joproductive, për shembull duke mos u përgatitur apo duke mos u paraqitur në seancë pa arsye të justifikueshme;
- Gjyqtarët duhet t'i aplikojnë masat ndëshkuese dhe disiplinore që i kanë në dispozicion sipas Kodit të Procedurës Penale.

### 2.2 Disa përparime në ritmin e gjykimit të rasteve të profilit të lartë

Pas një periudhe të gjatë në të cilën përparimi i rasteve të profilit të lartë, shumë prej të cilave janë ish-raste të EULEX-it, mbeti i ngadaltë ose ishte bllokuar plotësisht, një numër i tyre lëvizën përpara. Për shembull, pas shtatë seancave joproductive të njëpasnjëshme në periudhën midis datave 16 korrik 2018 dhe 25 qershor 2019, rasti "Olympus" (PKR 610/16), e njohur gjithashtu si rasti "Toka", filloi të përparonte. Nga shtatori i vitit 2019 deri në shkurt të vitit 2020, gjykata i ka caktuar seancat gjyqësore pothuajse në baza javore dhe shumica e tyre ishin produktive.

Pas vendimit për ndarjen e procedurave, u mbajt seanca e parë produktive më 3 korrik 2019, gjithashtu rasti “Grande” (PKR 305/2016) filloi të ecte gradualisht përpara. Gjithashtu, në gjysmën e dytë të vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020 u mbajtën disa seanca për rastin “Arratisja nga spitali” (PKR 685/2016), i cili kishte qenë joaktiv për më shumë se një vit që kur Gjykata e Apelit e kishte konfirmuar aktakuzën më 15 qershor 2018. Ngjashëm, në rastin “Gani Rama dhe Pal Lekaj” (PKR 16/2018) Gjykata Themelore i mbajti disa seanca në nëntor dhe dhjetor 2019 pas fillimit të rigjykimit më 7 nëntor 2019. Një shembull tjetër pozitiv është rasti “Veteranët” (PKR 230 /2018), i cili pas një pauze prej gati tetë muajsh (seanca fillestare u mbajt më 14 mars 2019), mori hov me pesë seanca që u mbajtën gjatë dhjetorit 2019 dhe shtatë në 2020 deri kur filloi zbatimi i masave kundër pandemisë. Gjithashtu, është për t’u theksuar se disa raste të profilit të lartë arritën fundin e gjykimit si “Pronto” (PKR 90/18) dhe “Syri i popullit” (PKR 46/2018).

Edhe pse me një ritëm më të ngadaltë, Rasti “3%” (P. 2022/2017) pa disa zhvillime me dy seancat e para produktive të tij të mbajtura në gusht 2019, të pasuara nga një tjetër në tetor duke pritur mbërritjen e ‘super ekspertizës’<sup>1</sup>. Për më tepër, rasti “Olympia” (PKR 236/2017) dhe rasti “City Club” (P.nr. 253/2016), vazhduan të shihnin më shumë aktivitetet që nga raporti i fundit. Sidoqoftë, ritmi ishte ende i ngadaltë me vetëm një seancë të planifikuar në çdo pesë deri në gjashtë-tetë javë, gjë që është veçanërisht e rëndësishme pasi që në të dy rastet njëri nga të pandehurit ndodhet në paraburgim. Rasti “Emin Krasniqi” (PKR 591/2016) është veçanërisht shqetësues duke e pasur parasysh se ende nuk është caktuar asnjë seancë e re prej muajit prill 2019, kur gjykata urdhëroi një ekspertim të ri kurse i pandehuri ndodhet në paraburgim për më shumë se tetë vjet.

Pavarësisht nga përparimi i raportuar në rastet e mësipërme, rastet tjera të profilit të lartë (përfshirë rastet që më parë i kishte EULEX-i) mbetën joaktive ose shënuan pak progres për arsye të ndryshme. Për shembull, në rastin “Drenica I” (PKR 74/2018), pas një periudhe të gjatë, seanca e planifikuar për 26 dhjetor 2019 u shty me kërkesë të prokurorit të çështjes. Në rastin “Naser Kelmendi” (PKR 32/2019) seancat ishin duke vazhduar deri kur filluan të zbatohen masat në lidhje me pandeminë, por me vonesa të shumta për shkak të mungesës së një përgjigje zyrtare nga Zyra e Bashkëpunimit Ligjor Ndërkombëtar në lidhje me dëshminë e një dëshmitari të mbrojtur i burgosur në Bosnjë dhe Hercegovinë. Gjithashtu, rasti “Olympia II” (PKR 611/2016) dhe rasti “Toka 4” (PKR 130/2016, që të dy të lidhur me “Olympia I”), nuk patën ndonjë përparim, njëjtë si rasti “Touareg” (P 176/2015), rasti “Transporti” (PKR 147/2016), rasti “Gazi lotsjellës” (PKR 70/2018) dhe e lidhur me këtë të fundit, rasti kundër “Pal Lekaj dhe të tjerëve” (PKR 108/2016) dhe rasti “Medicus” (PKR 226/2017). Për këto vonesa nuk u dha asnjë arsyetim i caktuar.

### **Rekomandim:**

- Gjykatat duhet të sigurojnë që gjykimet të mos shtyhen pa arsye

<sup>1</sup> Superekspertiza i referohet nenit 142 në Kodin e Procedurës Penale dhe zbatohet kur gjetjet e dëshmitarëve ekspertë janë në kundërshtim me njëra-tjetrën në të cilin rast ka nevojë për një dëshmitar tjetër ekspert apo ‘super ekspertizë’.

## **2.3 Funkcionimi i Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe në Gjykatën e Apelit në Prishtinë**

Funksionalizimi i Departamentit Special gjatë gjysmës së dytë të vitit 2019 ka pasur një ndikim pozitiv në efikasitetin e sistemit gjyqësor. Departamenti Special është departament i specializuar në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit në Prishtinë i cili merret vetëm me raste nga Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK). Ky departament merret me rastet penale më të rëndat. Procedurat në përgjithësi zhvillohen dhe përfundohen më shpejt sesa në kohën kur ato janë zhvilluar pranë Departamenteve për Krime të Rënda të Gjykatave Themelore të Ndryshme, e cila ka qenë procedura e zakonshme para funksionalizimit të Departamentit Special. Pritet që Departamenti Special të kontribuojë në një konsistencë të shtuar në vendimet gjyqësore dhe në një efikasitet dhe menaxhim të përmirësuar të rasteve nga Gjykata Themelore.<sup>2</sup> Një faktor tjetër pozitiv është se shumica e gjyqtarëve të caktuar në Departamentin Special i kanë përfunduar rastet e tyre të mëparshme në proces, që nënkupton se ata tani janë ekskluzivisht në dispozicion për rastet e tyre në Departamentin Special. Gjithashtu, është me rëndësi të theksohet se Departamenti Special, sipas rekomandimeve të EULEX-it në raportet e tij të mëparshëm të monitorimit tematik dhe sistematik, vendosi që të mos i organizojë gjyqtarët në trupa gjykues fikse<sup>3</sup> që ka një ndikim pozitiv në besimin e opinionit në pavarësinë dhe paanshmërinë e këtij departamenti.

Sidoqoftë, ekzistojnë edhe disa kufizime të mundshme të specializimit që duhet të merren parasysh. Për shembull, një departament ose gjykatë e specializuar mund ta ketë efektin e ndarjes së gjyqtarëve nga pjesa tjetër e gjyqësorit dhe kështu t'i ekspozojë ata ndaj presionit nga palët ose aktorët e tjerë.<sup>4</sup>

Disa sfida janë vënë re në lidhje me kapacitetin njerëzor dhe çështjet logjistike të Departamentit Special. E para, gjyqtarët e Departamentit Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës punojnë pa ndihmën e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe zyrtarëve ligjorë, pasi rekrutimet për këto pozita nuk kanë përfunduar ende, dhe me pajisje logjistike të pamjaftueshme, si kompjuterë dhe makina për fotokopjim. E dyta, duke e pasur parasysh numrin e rasteve në proces, numri prej gjashtë gjyqtarëve të caktuar në Departament duket i pamjaftueshëm. E njëjta mund të thuhet edhe në lidhje me Departamentin Special në Gjykatën e Apelit, ku tre gjyqtarë janë caktuar për të punuar ekskluzivisht në Departamentin Special në Gjykatën e Apelit në Prishtinë dhe tre gjyqtarë në Divizionin e Apelit në Mitrovicë. E treta, gjyqtarët në Divizionin e Apelit në Mitrovicë po ashtu caktohen në Departamentin e Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, çka është ngarkesë shtesë. Për më tepër, ata caktohen edhe nëpër panele të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, çka nënkupton se ata duhet të udhëtojnë nga Mitrovica në Prishtinë dhe anasjelltas. Ky është rasti kur gjyqtarët nga Prishtina përjashtohen nga pjesëmarrja në ndonjë panel të Gjykatës së Apelit dhe kështu duhet të zëvendësohen, çka nuk është e pazakontë duke pasur parasysh numrin e vogël të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

2 Shih Opinioni n°15 (2012) NO. 15 i Këshillit Konsultativ të gjyqtarëve evropianë të Këshillit të Evropës për specializimin e gjyqtarëve: <https://rm.coe.int/16807477d9>.

3 Panelet fikse me tre gjyqtarë të njëjtë shihen si më lehtë të kontrollueshme sesa panelet e gjyqtarëve që nuk janë fikse. Në rastin e dytë, të gjithë gjyqtarët caktohen në mënyrë rastësore, jo vetëm kryetari i trupit gjykues me dy anëtarë fikse të trupit gjykues.

4 Shih futnotën 3.

Gjithashtu, është identifikuar nevoja urgjente për ta krijuar një sistem në Pallatin e Drejtësisë i cili mundëson marrjen në pyetje të dëshmitarëve me masa mbrojtëse. Meqenëse Departamenti Special është kompetent për krime të rënda nën juridiksionin e PSRK-së, përdorimi i masave mbrojtëse për dëshmitarët është më i shpeshtë. Sidoqoftë, sa herë që ekziston nevoja për ta pyetur një dëshmitar, për shembull me anë të video thirrjes, Gjykata duhet ta zhvendosë seancën gjyqësore në Pejë, e cila është një prej pak gjykatave ku marrja në pyetje e dëshmitarëve të mbrojtur është e mundshme. Kjo procedurë krijon vonesa të panevojshme dhe e vë një barrë shtesë për palët ndërkohë që kjo potencialisht mund ta rrezikojë sigurinë e dëshmitarit(ëve) gjatë udhëtimit.

Për më tepër, mungesa e përkthyesve për gjuhët shqip/serbisht vazhdon të jetë një problem i madh në të dy departamentet speciale duke shkaktuar vonesa në përkthimin e dokumenteve gjyqësore, që paraqet shqetësim të veçantë në lidhje me vendimet për paraburgimin.

### **Rekomandime:**

- Të rritet numri i gjyqtarëve në Departamentin Special në shkallën e parë dhe nivelin e apelit në përputhje me dispozitat ligjore për përfshirjen etnike siç parashihet në ligj dhe në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit;
- Të rekrutohet personeli mbështetës shtesë si bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë;
- Të instalohen pajisjet e domosdoshme për të mundësuar pyetjen e dëshmitarëve nën masa mbrojtëse në Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë;
- Të rritet numri i përkthyesve për gjuhët shqip/serbisht.

### **2.4 Ndjekja e rasteve të terrorizmit**

Vlerësohet se gjithsej 400 kosovarë iu bashkuan konflikteve të armatosura në Siri dhe Irak. Në nivelin rajonal, Kosova është vlerësuar për përpjekjet e saj më të përparuara për kthimin e shtetasve të vet nga zonat e konfliktit dhe masat pasuese, përfshirë drejtësinë penale dhe ri-integrimin.

EULEX-i vuri re përpjekjet e vazhdueshme nga autoritetet e Kosovës për të ndjekur penalisht qytetarët që u kthyen më 19 prill 2019 nga vatrata e luftës në Siri, ku ata i ishin bashkuar organizatës terroriste Shteti Islamik ose Fronti Al-Nusra. Nga gjithsej 110 të kthyer, 32 ishin femra, 74 fëmijë dhe 4 meshkuj. Duke filluar nga data 23 prill 2019, shumica e grave u vendosën në arrest shtëpiak nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore të Prishtinës, ndërsa katër meshkujt u vendosën në paraburgim. Angazhimet për ri-integrim filluan me 74 fëmijët, që filluan shkollën fillore nga data 2 shtator 2019.<sup>5</sup> Gjatë kohës së këtij raporti, në lidhje me të rriturit e kthyer janë ngritur 25 aktakuza nga PSRK-ja në bazë të akuzave penale për anëtarësim në dhe organizim të grupit terrorist (neni 143 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës), si dhe disa raste të tjera që ende kanë mbetur në fazën e hetimeve.

Pas procedurave të shpejta gjyqësore përpara gjyqtarëve të Departamentit Special, të paktën tetë të pandehura femra u shpallën fajtoresh dhe iu shqiptuan dënime me kusht nga 2 deri në 2.5 vjet burgim. Disa nga gratë i thanë mediave se ishin mashtruar sa i përket shkuarjes në zonat

<sup>5</sup> Një numër i fëmijëve janë lindur jashtë vendit dhe asnjëherë nuk kanë qenë në Kosovë më parë, çka nënkupton se teknikisht këta fëmijë nuk janë duke u riintegruar në Kosovë.

e konfliktit në Siri dhe u penduan për vendimin e tyre, ndërsa disa treguan se ishin joshur me pagesa deri në 150 Euro në muaj të cilat atyre ua paguante Shteti Islamik. Shumica e grave kanë udhëtuar në Siri me bashkëshortët e tyre, ndërsa disa prej fëmijëve janë lindur në territor të huaj.

Rastet e të pandehurve meshkuj përmbanin akuza më të rënda, ku tre prej tyre janë dënuar tashmë me dënime me burgim prej 3.8, 4 dhe 5.5 vjet burgim. Të pandehurit femra vazhdimisht morën dënime me kusht në këmbim të pranimit të fajësisë nga ana e tyre, përveç detyrimeve për të marrë pjesë në masat e pazbuluara të riintegritit. Të pandehurit meshkuj morën dënime minimale gjithashtu duke marrë parasysh bashkëpunimin e tyre. Vlerësimi i efektivitetit të masave të rehabilitimit dhe riintegritit të ndërmarra nga autoritetet, të cilat kanë mbetur kryesisht të panjohura për opinionin, është i vështirë.

Një program de-radikalizimi për të dënuarit drejtohet nga Bashkësia Islame e Kosovës me Shërbimin Korrektues të Kosovës. Gjithashtu, një program ri-integrimi u formulua me ndihmën e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim IOM dhe partnerëve tjerë ndërkombëtarë dhe u paraqit për aprovim te Koordinatori Kombëtar Kundër Terrorizmit, megjithatë përmbajtja e tij mbeti e mbyllur për opinionin. Gjykata i detyroi femrat e dënuara që ta takojnë një psikolog për një periudhë të caktuar kohore, pa përmendur ndonjë detyrim për të marrë pjesë në masat e mëtejshme të ri-integritit.

### **Rekomandim:**

- Duke marrë parasysh ndarjen e shpejtë të drejtësisë në rastet e terrorizmit të cilat janë monitoruar, si dhe dënimet përgjithësisht të ulëta/me kusht, duket se barra komplekse dhe e vështirë e menaxhimit të rreziqeve të mundshme të ardhshme që lidhen me të kthyerit mbeti mbi shpatullat e policisë. Rezultati i kësaj duhet të monitorohet për së afërmi nga institucionet e Kosovës për sundim të ligjit.

## **2.5 Politika për rigjykimet në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovë**

Gjykata e Apelit e ka bërë praktikë të zakonshme dërgimin e një numri relativisht të madh të rasteve në gjykatat themelore përkatëse për rigjykim, përkundër nocionit që instrumenti i rigjykimit duhet të përdoret rrallë dhe të urdhërohet vetëm si përjashtim. Arsyeja e kësaj është se rigjykimi ndikon në të drejtat e të akuzuarit për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme në përputhje me nenin 6 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Dispozitat në Kodin aktual të Procedurës Penale të Kosovës lejojnë që Gjykata e Apelit të miratojë një qasje proaktive me rastin e gjykimit të ankesave kundër vendimeve të gjykatave themelore. Gjegjësisht, neni 403 i siguron panelit të Gjykatës së Apelit mundësinë për të mbajtur seanca dëgjimore, për të marrë prova të reja ose për t'i konfirmuar provat ekzistuese, në mënyrë që t'i përcaktojë dhe vlerësojë siç duhet faktet materiale. Sidoqoftë, monitorimi i praktikës gjyqësore ka zbuluar se dispozitat e nenit 403 pothuajse nuk merren fare për bazë. Në vend të kësaj, praktika e zakonshme e paneleve të Gjykatës së Apelit ka qenë anulimi i aktgjykimeve të gjykatave themelore dhe kthimi i rasteve në gjykatat përkatëse për rigjykim, duke vendosur kështu barrë shtesë dhe shpesh herë të panevojshme mbi gjykatat themelore, të cilat veçse janë duke u marrë me numër të konsiderueshëm të rasteve të grumbulluara.<sup>6</sup>

6 Neni 402 (1): Gjykata e Apelit, në raste të caktuara, anulon aktgjykimin e gjykatës themelore dhe çështjen e kthen në rigjykim kur vërteton se:

- 1.1. ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, dhe Gjykata e Apelit nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të këtij Kodi; ose
- 1.2. për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike duhet urdhëruar shqyrtim të ri gjyqësor në Gjykatën Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk mund të procedojë sipas nenit 403 të këtij Kodi.

Të dhënat statistikore të siguruara nga Gjykatat e Apelit për periudhën 2018 dhe 2019 e konfirmojnë trendin e një numri në rritje të rasteve të dërguara për rigjykim: 292 raste të dërguara për rigjykim në vitin 2018 krahasuar me 462 raste të dërguara për rigjykim në vitin 2019. Edhe pse numri i rritur i rasteve të dërguara për rigjykim mund të jetë pasqyrim i një numri në rritje të rasteve të gjykuara nga Gjykata e Apelit, monitorimi i rasteve nga EULEX-i konfirmoi se mekanizmi ligjor i përmendur që parashihet nga neni 403 pothuaj nuk shfrytëzohet fare nga Gjykata e Apelit.

EULEX-i po ashtu vuri re se disa aktgjykime nga rigjykimet të nxjerra nga gjykatat themelore nuk e pasqyrojnë sa duhet administrimin e provave nga rigjykimi, por kryesisht bazohen në aktgjykimin fillestar; janë monitoruar vonesa të mëdha në përpilimin dhe dorëzimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit që urdhërojnë rigjykimin e që rezulton në një zgjatje të panevojshme të kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore; udhëzimet e përfshira në vendimet e Gjykatës së Apelit që urdhërojnë rigjykimet ndonjëherë nuk janë mjaft precize dhe lënë hapësirë për interpretime. Një nga arsyt kryesore të cekura nga shkallët më të larta (Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme) për ta kthyer rastin në rigjykim është se dispozitivët janë në kundërshtim me arsyetimin. Sidoqoftë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë të drejtë ta modifikojnë aktgjykimin dhe ta korrigjojnë dispozitivin nëse është e nevojshme në vend që ta dërgojnë rastin në rigjykim.

### **Rekomandime:**

- Gjykata e Apelit duhet të shfrytëzojë më mirë mundësinë e dhenë nga Kodi i Procedurës Penale i Kosovës për të mbajtur seanca dëgjimore, për të marrë prova të reja apo për të konfirmuar provat ekzistuese, me qëllim të përcaktimit dhe vlerësimit të duhur të fakteve materiale, me qëllim të mënjanimit të anulimit të panevojshëm të aktgjykimeve dhe kthimit të rasteve në rigjykim;
- Drafti i ri i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përkufizon procedurën e rigjykimin si diçka e jashtëzakonshme, që duhet të përdoret vetëm në raste specifike. Kjo duhet të jetë nxitje shtesë për gjykatat e apelit që ato të përmbahen nga kthimi i panevojshëm i rasteve në rigjykim;
- Cilësia e aktgjykimeve duhet të përmirësohet, me fokus specifik në nevojën për harmonizim më të mirë të dispozitivëve dhe pjesës së arsyetimit të aktgjykimeve.

### **2.6 Caktimi i rasteve në procedurat e rigjykimin**

Gjatë monitorimit të procedurave gjyqësore, EULEX-i vuri re praktikën e gjykatave themelore që rastet të cilat kthehen për rigjykim me vendime të një gjykate më të lartë (zakonisht Gjykata e Apelit) t'ia caktojë të njëjtit kryetar të trupit gjykues, ose trupi gjykues, i cili e ka trajtuar fillimisht rastin në gjykatën themelore.

Neni 39 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i cili e trajton papërshtatshmërinë e gjyqtarëve, e ndalon që një gjyqtar të shërbejë si kryetar i trupit gjykues, gjyqtar individual ose anëtar i trupit gjykues, në rastet kur ata kanë marrë pjesë në procedurat e mëparshme për të njëjtin rast penal, ku përjashtim bëhet vetëm për gjyqtarët që kanë shërbyer në një panel për raste të posaçme hetimore ose në ndonjë panel shqyrtues. Gjykatat e Kosovës vazhdimisht i kanë interpretuar këto dispozita në atë mënyrë që rastet e kthyera për rigjykim përbëjnë procedura të reja. Në fakt, atyre edhe u jepen numra protokolli të rinj.

Si pasojë imediate, procedurat e rigjyimit zhvillohen shumë më shpejtë, ku si palët ashtu edhe gjykata janë mirë të njoftuara me rastin. Si pasojë e menjëhershme, procedurat e rigjyimit zhvillohen shumë më shpejt, ku si palët ashtu edhe gjykata janë të familjarizuar mirë me rastin në fjalë. Gjatë procedurave të provave, gjykata zakonisht përpunon vetëm ato prova për të cilat ajo ishte udhëzuar në mënyrë të posaçme që t'i administrojë ose ri-administrojë. Në disa raste, të gjitha procedurat e rigjyimit zhvillohen në një seancë të vetme,<sup>7</sup> në veçanti ku fushëveprimi për rigjykim është vetëm i pjesshëm. Këtyre procedurave u mungojnë hollësitë ose plotësia që rigjykimi duhet t'i ketë, meqë ato nuk merren me provat e plota. Nganjëherë gjykata më e lartë urdhëron rigjykime të përsëritura (si në rastin Medicus) të cilat e vonojnë ndarjen e drejtësisë edhe më tej dhe në mënyrë të konsiderueshme.

Ç'është më e rëndësishmja, gjyqtarëve të gjykatave themelore u paraqitet një dilemë etike për të gjykuar në bazë të provave faktike të njëjta ose të ndryshuara shumë pak, dhe në fund duhet t'i rivlerësojnë vendimet e tyre të mëparshme, e që kjo mund ta ngrejë çështjen e paanësisë së tyre. Në disa raste të monitoruara, procedurat e rigjyimit që po trajtoheshin nga të njëjtët gjyqtarë e acaruan atmosferën, ku palët dhe anëtarët e trupit gjykues hynë në debate të ashpra, duke kërkuar përjashtimin e gjyqtarëve ose prokurorëve,<sup>8</sup> ose duke ofenduar personalisht njëri-tjetrin.<sup>9</sup> Palët ankesat e të cilave ishin miratuar shpesh janë parë duke reaguar me frustrim dhe mosbesim në drejtësinë e procedurave të reja, duke supozuar se ishte shumë e pamundur të pritej që gjyqtarët do të arrinin në një përfundim të kundër nga ai që ata vet e kishin shpallur në gjykimin fillestar pa e humbur fytyrën apo kredibilitetin.

Neni 398 (2) Kodi i Procedurës Penale i jep gjykatës së apelit kompetencën për të bërë ndryshime në përbërjen e trupit gjykues i cili merret me rigjykimin, që nënkupton se nuk ka nevojë për t'i kthyer rastet e rigjyimit automatikisht tek gjyqtari apo trupi gjykues i njëjtë në gjykatën themelore. Ndonëse praktika aktuale gjyqësore është efikase në aspektin kohor, ajo vije me koston e lartë të provokimit të paanshmërisë së gjyqtarëve. Për më tepër, ajo e konsolidon një sistem ku rigjykimet janë të prirura për procedura të parëndësishme, duke e zhvlerësuar të drejtën për rishikim adekuat gjyqësor nga një gjykatë e paanshme.

Implikimet e drejtpërdrejta në standardet dhe garancitë e të drejtave të njeriut bien nën Nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në veçanti në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë brenda një periudhe kohore të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka njohur lidhjen e ngushtë midis koncepteve të pavarësisë dhe paanësisë objektive, zakonisht duke i marrë parasysh këto dy kritere së bashku.<sup>10</sup> Ekzistojnë dy situata të mundshme në të cilat lind çështja e mungesës së paanësisë gjyqësore.<sup>11</sup> E para është *funksionale* në natyrën e saj dhe, për shembull, ka të bëjë me ushtrimin e funksioneve të ndryshme brenda procesit gjyqësor nga i njëjti person, ose lidhjet hierarkike ose të tjera me një person tjetër të përfshirë në procedurë. E dyta është e një karakteri *personal* që rrjedh nga sjellja e gjyqtarëve në një rast të caktuar. Kategoria e parë përfshin ushtrimin e

7 Rasti Esat Fejza, P 77/2018, Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj; Rasti Hummer, P 113/2019 Gjykata Themelore në Mitrovicë.

8 Rasti i vrasjes së dyfishtë në Gjakovë, PKR 43/2019 - Gjykata Themelore në Gjakovë.

9 Rasti Hummer, P 113/2019 Gjykata Themelore në Mitrovicë.

10 Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 73.

11 Kyprianou kundër Qipros [GC], § 121.

mëparshëm të funksioneve të ndryshme gjyqësore nga ndonjë anëtar i gjyqësorit në procedurën e njëjtë. Për shembull, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcaktoi se kur lind çështja e animet në lidhje me pjesëmarrjen e mëparshme të një gjyqtari në procedurë, një kalim kohe prej gati dy vjetësh që nga përfshirja e mëparshme në të njëjtën procedurë nuk është në vetvete një garanci e mjaftueshme kundër anshmërisë.<sup>12</sup>

Në rastet kur një gjyqtar tashmë ka nxjerrë vendime plotësisht zyrtare dhe procedurale në faza të tjera të procesit nuk lind çështja e mungesës së paanshmërisë gjyqësore. Megjithatë, problemet me paanshmërinë mund të shfaqen nëse, në faza të tjera të procesit, një gjyqtar ka shprehur tashmë një mendim mbi fajësinë e të akuzuarit.<sup>13</sup>

Këshilli i Evropës ka deklaruar se organizimi hierarkik gjyqësor nuk duhet ta minojë pavarësinë individuale<sup>14</sup>. Caktimi i rasteve brenda një gjykate duhet t'i përmbahet kriterëve objektive të paracaktuara në mënyrë që të mbrohet e drejta për një gjyqtar të pavarur dhe të paanshëm<sup>15</sup>, të cilat duhet të respektohen jo vetëm kur rasti i caktohet për herë të parë një gjyqtari apo një trupi gjykues, por edhe kur e i njëjti kthehet për rigjykim nga një gjykatë më e lartë.

### **Rekomandim:**

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet ta vlerësojë praktikën aktuale gjyqësore dhe implikimet e saj dhe nëse konsiderohet e duhur, të vendos që ta nxjerrë një vendim ose interpretim udhëzues, ose përndryshe të ndër marrë veprimet e nevojshme ligjore me qëllim që të sigurojë një interpretim dhe zbatim konsistent të dispozitave përkatëse, për të siguruar që të ruhet dhe konsolidohet paanshmëria dhe pavarësia e gjyqësorit.

## **2.7 Pyetjet e tërthorta**

Sipas nenit 6 (3) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kushdo që akuzohet për një veprë penale ka të drejtë që t'i pyes, ose dikush t'i pyet, dëshmitarët kundër tij ose saj si një e drejtë minimale. Përgjatë monitorimit të rasteve nga EULEX-i, janë vërejtur sfidat e mëposhtme sa i përket zbatimit të duhur të pyetjeve të tërthorta:

- Shkalla e përputhshmërisë me rregullat e pyetjeve të tërthorta në seancat kryesore varet shumë nga përbërja e trupave gjykues, veçanërisht nga kryetarët e trupit gjykues. Kështu, zbatimi jo konsistent i pyetjeve të tërthorta është vërejtur në të gjithë Kosovën, gjë që ngre shqetësime mbi parimet ligjore përcjellëse, si “siguria juridike”;
- Në përafërsisht gjysmën e seancave gjyqësore të monitoruara, është vërejtur se shumica e pyetjeve të bëra nga palët ishin përtej fushëveprimit të pyetjeve të tërthorta. Për më tepër, palët herë pas here e ngatërronin llojin e pyetjeve të lejuara për pyetje të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (p.sh. pyetjet e drejtpërdrejta u lejuan gjatë pyetjeve të tërthorta dhe anasjelltas). Si pasojë, kryetari i trupit gjykues ose anëtarët e tjerë të trupit gjykues kushtuan kohë të konsiderueshme duke u kërkuar palëve që të riformulonin pyetjet e tyre; këto kushte rezultuan në gjykime të zgjatura dhe humbjen e fillit të zhvillimeve në seancat kryesore. Kjo mund të ketë ndikim negativ në efikasitetin dhe kohëzgjatjen e procedurave penale;

<sup>12</sup> Dāvidsons dhe Savins kundër Letonisë, § 57.

<sup>13</sup> Gómez de Liaño y Botella kundër Spanjës sin, §§ 67-72.

<sup>14</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Këshillit të Ministrave për vendet anëtare për gjyqtarët: pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësinë; Kreu III – Pavarësia e brendshme, Para. 22.

<sup>15</sup> Ibid. Para 24.



- Është vërejtur gjithashtu shpesh herë që palët përgjegjëse për pyetjet e tërthorta nuk ishin të përgatitura në mënyrën adekuate. Duke marrë parasysh që pyetjet e tërthorta përbëjnë një mundësi për palën kundërshtare për t'i kundërshtuar ngjarjet e pretenduara faktike dhe për ta kërkuar të vërtetën materiale, mungesa e përgatitjes i zvogëlon gjasat për mbrojtjen e të drejtave të palëve të përfshira dhe e pengon cilësinë e gjykimeve penale;
- Ka pasur edhe raste kur është lejuar ripyetja e tërthortë, pas marrjes në pyetje në mënyrë të tërthortë të një dëshmitari ose një të pandehuri, veçanërisht kur prokuroria ishte pala që bënte pyetje të tërthorta. Sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (Neni 333 dhe nenet vijuese), një raund tjetër i pyetjeve të tërthorta nuk duhet të lejohet. Në mënyrë të ngjashme, është vërejtur gjithashtu se herë pas here lejoheshin disa raunde të pyetjeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale. Këto rrethana mund të ngrejë çështje mbi ligjshmërinë e procedurës, si dhe për parimin e barazisë së armëve;<sup>16</sup>
- Kundërshtimet e paraqitura nga palët kundërshtare për pyetjet e tërthorta ishin shpesh të paqarta dhe/ose të pabazuara, gjë që rezultoi në vonesa të panevojshme të përparimit të gjykimeve. Për më tepër, herë pas here trupat gjykues ose kryetarët e trupave gjykues nuk i pranonin kundërshtimet e palëve pa dhënë vendime të arsyetuara mirë, pavarësisht nga natyra legjitime e disa kundërshtimeve gjatë pyetjeve të tërthorta. Kjo, sipas radhës, mund të ngrejë çështje të arbitraritetit dhe paanshmërisë në procedurat penale

### **Rekomandime:**

- Gjyqtarët duhet të jenë më të vendosur në mbrojtjen e zbatimit të ligjshëm të rregullave për pyetjet e tërthorta gjatë shqyrtimeve kryesore, por duhet nënvizuar se edhe palët e kanë përgjegjësinë e tyre në zbatimin e duhur të pyetjeve të tërthorta.
- Iniciativat për ta përmirësuar cilësinë e pyetjeve të tërthorta në shqyrtimet kryesore mund të përfshijnë:
- Përgatitjen e kurseve në internet me udhëzime dhe këshilla praktike ad-hoc në lidhje me pyetjet e tërthorta për praktikuesit ligjorë, të zhvilluara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe/ose Oda e Avokatëve të Kosovës, si dhe të jenë në dispozicion të profesionistëve ligjorë pa pagesë;
- botimi i një manuali për pyetjet e tërthorta për praktikuesit e ligjit të shkruar nga një gamë e gjerë profesionistësh ligjorë, kryesisht nga ata që përfshihen aktivisht në gjykime penale (p.sh. gjyqtarë, prokurorë, avokatë mbrojtës);
- zbatimi i aktiviteteve me qëllim të rritjes së vetëdijesimit për pyetjet e tërthorta (p.sh. theksimi i ligjërimit për pyetjet e tërthorta në fakultetet juridike, rritja e numrit të pyetjeve të drejtuara në pyetjet e tërthorta gjatë provimeve të jurisprudencës; organizimi i garave me gjykime të simuluar për studentët e drejtësisë dhe avokatët e rinj.)

<sup>16</sup> Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, barazia e armëve është karakteristikë e qenësishme e gjykimit të drejtë që kërkon që secila palë e procedurës (ndjekja penale dhe mbrojtja) iu jepet mundësi e arsyeshme për ta prezantuar rastin e tyre me kushte që nuk i vënë ata në disavantazh vis-à-vis kundërshtarit të tyre.

## **2.8 Shpallja e aktgjykimeve për raste penale në shkallë të parë**

Bazuar në monitorimin e 28 shpalljeve të aktgjykimeve në shkallën e parë, EULEX-i identifikoi disa mospërputhje.<sup>17</sup> Në monitorimin e tij, EULEX-i u përqendrua në tiparet kryesore të shpalljeve të gjykimeve, duke përfshirë leximin adekuat të veprës penale, justifikimin ose arsyetimin, udhëzimet për ankesë dhe dëgjueshmërinë e leximit për palët dhe për publikun siç përcaktohet nga Kodi i Procedurës Penale.

Bazuar në këto kritere, EULEX-i ka identifikuar parregullsi në 13 prej gjithsej 28 shpalljeve të aktgjykimeve. Në gjashtë raste vepra penale nuk ishte cituar, në dhjetë raste paraqitja e një arsytimi të shkurtër ishte lënë plotësisht anash kurse në tre raste ishte i pamjaftueshëm, në shtatë raste palëve nuk u ishin dhënë udhëzime në lidhje me mjetet juridike dhe në pesë raste shpallja ishte e mangët për shkak të faktit se gjyqtari pa mëdyshje nuk mund të dëgjohej ose kuptohej.

Përveç kësaj, në tri shpallje të aktgjykimeve, ishte theksuar se aktgjykimet ishin arritur me vendim unanim të anëtarëve të trupit gjykues. Duhet të theksohet se fshehtësia e shqyrtimit vendimtar dhe votimit përcaktohet në nenet 473 dhe 320 të Kodit të Procedurës Penale, dhe procesverbali është në dispozicion vetëm për gjykatën më të lartë. Prandaj, zbulimi i këtij informacioni është në kundërshtim me këto dispozita ligjore.

EULEX-i gjithashtu monitoroi që në dy raste aktgjykimet ishin shpallur në zyrën e gjyqtarit. Shpallja e aktgjykimet në zyrën e gjyqtarit paraqet shkelje të parimit të publicitetit pasi kërkohet që dispozitivi të lexohet në gjykatë të hapur. Rëndësia e shpalljes publike të aktgjykimet është nënvizuar gjithashtu në nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili thotë se aktgjykimi duhet të shqyrtohet publikisht. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur se, “mjetet e tjera për ta bërë një aktgjykim publik” gjithashtu mund të jenë në përputhje me nenin Konventën, sidoqoftë kjo ende nuk vlen në rastet e lartcekura, pasi që publiciteti i aktgjykimet nuk ishte siguruar me mjete të tjera.<sup>18</sup>

### **Rekomandim:**

- Ekziston nevoja për trajnime më efektive të gjyqtarëve. *Diskutimet në forume profesionale midis gjyqtarëve të shkallëve të ndryshme gjithashtu mund ta adresojnë në mënyrë efektive këtë shqetësim.*

17 Prej 28 gjykimeve, e 22 ishin gjykime për fajësi, ku pranimi i fajësisë apo marrëveshjet për pranimit të fajësisë janë bërë në shtatë raste dhe gjashtë gjykime me lirim nga fajësia.

18 Kur lexohet publikisht vetëm pjesa e hyrjes në fuqi të aktgjykimet, duhet të konstatohet nëse publiku kishte qasje me mjete të tjera në aktgjykimin e arsyetuar i cili nuk ishte lexuar dhe, nëse po, format e publicitetit të përdora duhet të shqyrtohen në mënyrë që aktgjykimi t'i nënshtrohet shqyrtimit publik. (Ryakib Biryukov kundër Rusisë, §§ 38-46 dhe referencat e cituara në §§ 33-36).

## 2.9 Paraburgimet

Përmes monitorimit të rasteve, EULEX-i ka vënë re diçka që duket të jetë varësi e tepruar në masën e sigurisë së paraburgimit. Gjatë periudhës së raportimit, EULEX-i ekzaminoi tri raste që përfshinin paraburgimi ne disa zyrtarëve korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës si të pandehur, ku ata kryesisht akuzohen për kryerjen e krimit të “Lirimit të paligjshëm të personave të privuar nga liria”.<sup>19</sup> Të gjitha këto tri raste kanë të bëjnë me incidentet në Klinikën Universitare të Kosovës.<sup>20</sup> Asnjëri nga këto tri raste nuk është ende në shqyrtim kryesor gjyqësor, ndërsa në të gjitha rastet ishte caktuar paraburgimi. Në dy raste, të pandehurit u liruan pas rreth një muaji kurse në një rast pas rreth dy muajsh ose masa e sigurisë ndaj tyre u ndryshua në arrest shtëpiak.

Duke e marrë parasysh që caktimi i paraburgimit është kufizimi më i rëndë i të drejtave të njeriut gjatë procedurave penale sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih nenin 5 par. 1 (c) (E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë)<sup>21</sup> dhe faktin që paraburgimi ishte caktuar për një kohë relativisht të shkurtër, ndërsa ende nuk ishte zhvilluar shqyrtimi gjyqësor kryesor, EULEX-i vendosi që të bëjë një analizë të vendimeve përkatëse.

EULEX-i ka vërejtur mangësi tek vendimet për caktimin e paraburgimit në të tria rastet. Në rastin e parë,<sup>22</sup> vendimi caktoi paraburgim për një muaj formalisht cilësoi veprën në dispozitivin e tij, si dhe në arsyetimin e tij si “Masëtrim”<sup>23</sup>, megjithëse prokuroria e kishte cilësuar veprën shprehimisht si “Lirim të paligjshëm të personave të privuar nga liria”. Përveç kësaj, gjykata i ishte referuar një rreziku të ikjes pa argumente faktike, rrezik të cilin prokuroria as nuk e kishte përmendur në kërkesën e saj. Një muaj më vonë të dy të pandehurit u lanë të lirë me kërkesë të prokurorisë.

Në rastin e dytë<sup>24</sup>, vendimi fillestar për caktimin e paraburgimit për një muaj nuk e shtjelloi dyshimin e bazuar për kryerjen e një veprë penale. Vendimi i referohet vetëm dokumenteve në shkresat e lëndës. Vendimi pasues mbi vazhdimin e paraburgimit u lëshua përsëri pa i vërtetuar faktet për dyshimin e bazuar dhe ai u ankimua nga i akuzuari. Gjykata e Apelit nuk e sqaroi këtë lëshim të gjykatës së shkallës së parë. Megjithatë, ajo e ndryshoi masën në një më të butë, përkatësisht në arrest shtëpiak.

Në rastin e tretë<sup>25</sup>, gjykata veprroi sipas kërkesës së prokurorisë dhe së pari e caktoi paraburgimin për 15 ditë, dhe më pas e zgjati atë për dy muaj dhe përfundimisht e ndryshoi masën në arrest shtëpiak. Gjykata, në të tri vendimet argumentoi se ekziston rreziku i ikjes, pa i shtjelluar faktet përkatëse. Për më tepër, vendimet bien ndesh me njëri-tjetrin: ndryshimi nga paraburgim në arrest shtëpiak si masë më e butë sigurie pas dy muajsh ishte arsyetuar me të njëjtin rrezik të

19 Sipas nenit 399 (Ligji nr. 06/L-074) dhe nenit 407 (Ligji nr. 04/L-082, i aplikueshëm deri më 14.04.2019) respektivisht Kodi Penal i Kosovës.

20 Një incident ka ndodhur në fund të vitit 2017, kurse dy në mesin e vitit 2019.

21 Sipas nenit 187 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata mund të urdhërojë paraburgim [nëse]:

1.1. ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale;

1.2.1. [...] se ekziston rreziku i ikjes;

1.2.2. [...] se ai apo ajo do të pengojë zhvillimin e procedurave penale përmes ndikimit tek dëshmitarët [...];

1.2.3. pesha e veprës penale [...] ose [...] rrezik që ai ose ajo do të përsërisë veprën penale [...] dhe

1.3. masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit [...] do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë [...].

22 Numri i Prokurorisë: PP.II.nr. 11/2017; (procedurë paraprake) numri në gjykatë: PPR.nr.295/2017.

23 Sipas nenit 323 (Ligji nr. 06/L-074) KPK.

24 Numri i Prokurorisë: PP.II.nr. 2557/2019; numri i gjykatës (shqyrtimi paraprak): PPR.nr.351/2019.

25 Numri i Prokurorisë: PP.II.nr. 3078/2019; numri i gjykatës (shqyrtimi paraprak): PPR.nr.461/2019.

ikjes që ishte përdorë si arsytim për caktimin fillestar të paraburgimit. Rrjedhimisht, Gjykata sipas arsytimit të saj do të duhej të ishte e obliguar që ta caktonte masën më të butë të arrestit shtëpiak që nga fillimi e jo masën e paraburgimit.

Mund të konkludohet se asnjë nga këto raste nuk është në përputhje me nenin 187 të Kodit të Procedurës Penale (dhe kështu as me Nenin 5 par. 1 (c) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut). Rrjedhimisht, shqiptimi i paraburgimit pati efektin e zëvendësimit të ndonjë dënimi eventual, pa shqyrtim gjyqësor kryesor. Këtu janë shkelur një sërë parimesh, si e drejta për t'u paraburgosur vetëm pas dënimit nga një gjykatë kompetente (neni 5 paragrafi 1 (a) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), e drejta për seancë dëgjimore të drejtë dhe publike nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme (neni 6 par. 1 (E drejta për gjykim të drejtë) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) dhe e drejta për prezumimin e pafajësisë derisa të vërtetohet fajësia (neni 6 par. 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

### **Rekomandime:**

- Kërkesat e prokurorisë për caktimin e paraburgimit dhe vendimet përkatëse të gjykatës duhet të arsyetohen me fakte konkrete në një mënyrë që i pandehuri të jetë në gjendje ta kuptojë vendimin;
- Në rast se plotësohen kushtet për caktimin e një mase sigurie, duhet të urdhërohet masa më e butë kurse paraburgimi duhet të jetë mjeti i fundit;
- Me rëndësi është se duhet të merret parasysh që zyrtarët e Shërbimit Korrektues të Kosovës janë paraburgosur jo vetëm në të njëjtin objekt në të cilin punojnë, por në të vërtetë në qelitë me të burgosurit të cilët ata duhej t'i ruanin më parë. Kjo situatë është potencialisht armiqësore. Ajo paraqet rrezik për sigurinë e zyrtarëve korrektues dhe për më tepër mund të ketë efekt psikologjik mbi ta. Në një rast, fillimisht oficerët korrektues kishin madje të veshura uniformat e tyre zyrtare derisa po paraburgoseshin.

### ***2.10 Konfiskimi dhe konfiskimi i përkohshëm i pasurisë***

Legjislacioni për konfiskimin parasheh mekanizma të ndryshëm procedural për subjektet gjyqësore për ta zbatuar sekuestrimin dhe konfiskimin e përkohshëm të pasurisë. EULEX-i ka identifikuar nevojën për përmirësimin e efektivitetit të zbatimit të kornizës së aplikueshme në këtë fushë, pasi ekzistojnë mekanizma procedural që nuk janë përdorur gjerësisht.

Së pari, shuma e pasurive të konfiskuara është shumë më e ulët se shuma e pasurive të konfiskuara përkohësisht. Në aspektin pozitiv është vërejtur se prokuroria shpesh përdorë konfiskim të përkohshëm të pasurisë. Sidoqoftë, shuma në lidhje me konfiskimin final është krahasimisht shumë më e ulët<sup>26</sup>.

<sup>26</sup> Sipas statistikave të ofruara nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (Agjencia) vlera e pasurive të administruara nga Agjencia deri në mars 2020 ishte si më poshtë: pasuritë e sekuestruara - 1,021,664.04 Euro; pasuritë e konfiskuara - 80,613.30 Euro; kthimi i pasurive - 274,095.53 Euro. Gjatë periudhës raportuese të vitit 2017, Agjencia ekzekutoi gjithsej 138 vendime nga të cilat 78 vendime ishin për sekuestrim të pasurive, 39 vendime për konfiskim të pasurive, 18 vendime për kthimin e pasurive të sekuestruara dhe 3 vendime për dhënie të pasurive për përdorim nga institucionet shtetërore. Gjatë periudhës raportuese të vitit 2018, Agjencia ka ekzekutuar gjithsej 110 vendime, nga të cilat, 64 vendime ishin për pranimin e pasurive të sekuestruara, 14 vendime për pranimin e pasurive të konfiskuara, 21 vendime për kthimin e pasurive të

Një arsye prapa kësaj mund të lidhet me numrin e lartë të lirimit nga akuzat në rastet e korrupsionit, veçanërisht në rastet e profilin të lartë.

Së dyti, shitja e parashikuar e pasurive gjatë procedurave, të porpozuar nga prokuroria për të shmangur humbjen e vlerës, nuk aprovohet gjerësisht nga gjykatat<sup>27</sup>. Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (Agjencia) ka bërë afërsisht 300 propozime për shitje në prokurori gjatë viteve të fundit, por vetëm disa janë aprovuar nga gjykatat, përkundër memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar së fundmi midis Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Agjencisë në këtë drejtim. Në periudhën 2016 – 2019, vlera e shitjes së pasurisë së konfiskuar arriti gjithsej 252,700 euro, vlerë kjo e ulët.

Vlen të përmendet se qëllimi i këtij mekanizmi është thjeshtë për të shmangur humbjen e vlerës së pasurisë, që ndodh shpesh me automjete të sekuestruara përkohësisht, ku kostot e magazinimit të tyre janë joproportionale me vlerën e asetit apo edhe e tejkalojnë vlerën e tyre. Shitja e parashikuar e pasurive nuk ka të bëjë me dënimin ose mos-dënimin e të pandehurit. Të ardhurat nga shitja e pasurive të sekuestruara depozitohen në llogarinë bankare të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës dhe u kthehen të pandehurve në rast të lirimit nga akuzat.

Së treti, Ligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë i cili ka hyrë në fuqi më 10 janar 2019 nuk është zbatuar ende. Ligji i ri për kompetencat e zgjeruara ka shtuar numrin e veprave penale për të cilat parashihet konfiskimi dhe ka zgjeruar mundësinë e konfiskimit të pasurisë jo vetëm prej të pandehurve por edhe prej palëve të treta, nëse ata i kanë blerë pasurinë në besim jo të mirë. Ndonëse disa prej mekanizmave të parashikuara në ligj janë të aplikueshëm vetëm pas dënimit të formës së prerë (numri i të cilëve është shumë i ulët, pas parasysh procedurat e gjata të ankimit), ekziston një nevojë urgjente për ta filluar zbatimin e tij në mënyrë që të sigurohet efektiviteti i kornizës ligjore të konfiskimit.

### **Rekomandim:**

- Të fillohet zbatimi i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë dhe të përdoret më shpesh mundësia e shitjes së pasurive.

---

sekuestruara dhe 11 vendime për dhënie e pasurive të konfiskuara për përdorim nga institucionet shtetërore. Gjatë periudhës raportuese të vitit 2019, Agjencia ekzekutoi një total prej 136 vendimesh nga të cilat 87 vendime janë për sekuestrim, 30 për konfiskim dhe 19 vendime për kthim. Gjatë periudhës së raportimit 1 janar 2020 - 30 mars 2020, Agjencia ekzekutoi gjithsej 45 vendime, prej të cilave 42 vendime për sekuestrim, 2 për konfiskim dhe 1 vendim për kthim.

<sup>27</sup> Në pajtim me nenin 27 para. 1 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar “Me propozim të Agjencisë, Prokurori i shtetit, apo organi tjetër kompetent mund të kërkojë nga gjykata të vendosë për shitjen e një pasurie që mund ta humbë vlerën ose në rast të magazinimit të saj e tejkalon vlerën e saj, apo kur shpenzimet e magazinimit janë joproportionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar. Pasuritë e tilla përfshijnë kafshët/bagëtitë, dhe pasuri të cilat e humbin shpejt vlerën e tyre”.

## 3. GJETJET NGA MONITORIMI TEMATIK

### 3.1 Anti-korrupsioni

Task Forca Anti-Korrupsion e Policisë së Kosovës luan rol esencial në fushën e zbulimit, hapave fillestar dhe hetimeve kundër korrupsionit. E themeluar me vendim të Qeverisë në vitin 2010, në bashkëpunim me EULEX-in, sukseksi i Task Forcës ruhet nga pozita e saj unike në hierarkinë e Policisë së Kosovës dhe vijat e saj të veçanta të raportimit, gjë që garantojë pavarësinë e saj. Ndonëse njësia përbëhet prej 30 hetuesve dhe 1 eksperti financiar, hetimet e saj të ndërlikuara dhe voluminoze do të përfitonin nga rritja e kapaciteteve dhe e mbështetjes. EULEX-i ka vënë re se Task Forca ka zbuluar dhe ndërmarrë hetime të profilit të lartë që përfshijnë persona të njohur dhe të ekspozuar politikisht, si dhe raste të ndërlikuara financiare, siç janë ato që ndërlidhen me privatizime apo tenderë publikë, që i kanë shkaktuar buxhetit publik dëme të vlerësuara në miliona euro buxhetit publik.

Agjencia udhëheqëse në fushën e anti-korrupsionit vazhdon të jetë Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK). Përveç ndryshimeve tek udhëheqësia (emërimi i kryeprokurorit të ri të PSRK-së) dhe stafi i saj (rekrutimi i dy prokurorëve të ri dhe pensionimi i një prokurori), PSRK-ja po ashtu ka kaluar nëpër një riorrganizim shumë të mirëpritur me katër departamente, që përfshinë një për antikorrupsion dhe krime financiare, pas miratimit të një strategjie gjithëpërfshirëse në shkurt 2020. Kjo ka rezultuar në përpjekje të përqendruara për trajtimin e korrupsionit të shkallës së gjerë dhe ka për qëllim specializimin e mëtejshëm të prokurorëve të PSRK-së, i tëri ky zhvillim pozitiv.

Niveli i bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes policisë dhe prokurorisë vazhdon të jetë shqetësues. Disa gjetje kanë sugjeruar transparencë dhe llogaridhënie të pamjaftueshme të prokurorisë, apo ngurrim për të përmbushur rolin e tyre mbikëqyrës siç është e përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale. Një numër i kërkesave të policisë kanë mbetur të papërgjigjura nga PSRK-ja për periudha kohore të gjata, në dëm të hetimeve. Në një hetim specifik, EULEX-i ka identifikuar një konflikt afatgjatë të juridiksionit mes Task Forcës Anti-korrupsion dhe Inspektoratit Policor, ndërsa prokurori i rastit ka qëndruar joaktiv.

Derisa shumica e hetimeve janë zhvilluar me profesionalizëm, ku policia dhe prokuroria kanë përdorë një gamë të gjerë të mjeteve dhe teknikave hetimore (përfshirë punë forenzike, masa hetimore speciale dhe të fshehta, bashkëpunim ndërkombëtar), EULEX ka vënë re se një numër i hetimeve financiare të ndërlikuara janë përfunduar pa i eksploruar të gjitha pistat për grumbullimin e provave. Skemat financiare kyçe, dëshmitarët apo regjistrat e korporatave nuk janë eksploruar apo janë hetuar pamjaftueshëm. Kjo mënyrë e punës shpije në situatë ku rastet bazohen në prova të pamjaftueshme apo të paqarta, duke e rrezikuar kështu rezultatin e procesit gjyqësor. Për më tepër, parimi “ndiq paratë”, i cili është i një rëndësie supreme për hetimin e pastrimit të parave dhe krimit financiar, në përgjithësi neglizhohet.

Një numër i rasteve që përfshijnë zyrtarë të profilit të lartë kanë ngecur apo kanë shënuar regres. Disa hetime kanë ngecur për shkak të bashkëpunimit të mangët mes policisë dhe

prokurorisë. Është vërejtur një tendencë që disa raste të mbahen në fazën fillestare, ndërsa hapja e hetimeve zyrtare vonohej nga PSRK-ja deri në momentin e fundit, ndoshta me qëllim të zgjatjes së procedurës në mënyrë të hetimet të zgjaten përtej afatit kohor ligjor prej dy viteve, apo për zbutjen e presioneve të tjera. Përkundër vlerësimeve pozitive nga Këshilli Prokurorial i Kosovës për angazhimet kundër korrupsionit, disa prokuror të PSRK-së kanë pasur vështirësi për t'u ballafaquar me rastet e shumta apo me kapacitete të pamjaftueshme (përfshirë staf prokurorial ndihmës). Disa prej këtyre çështjeve megjithatë janë trajtuar, siç është përmendur, në Strategjinë e PSRK-së të miratuar në shkurt 2020.

Në përgjithësi është vërejtur se shumë prej të dyshuarve dhe të pandehurve pjesë e gjykimeve për raste të korrupsionit ishin shumë të pasur dhe me ndikim, me lidhje politike apo financiare të forta, çka padyshim se mund të shpije në presion apo ndërhyrje në këto procedura penale. Në të vërtetë, nga monitorimi është vënë re se rastet e korrupsionit të profilit të lartë shpesh kanë përfunduar me shkallë të ulët të dënimit apo lirime nga akuza që kanë bërë bujë (p.sh. “Rasti Pronto”, “Rasti i KEK-ut”, “Privatizimi i FAN-it”, “Menaxherët e Telekomit”, “Kryetari i Suharekës dhe të tjerët”) apo me vendime nga gjykata më të larta për t'i kthyer rastet në rigjykim, tipar negativ i analizuar më tej në pjesën e raportit që flet për monitorimin sistematik.

Në lidhje me deklarin e pasurisë nga zyrtarët publikë, EULEX ka monitoruar disa raste, përfshirë atë të ish-kryetarit të Klinës, Sokol Bashota. Pas ngritjes së aktakuzës për akuza më të gjera për korrupsion në vitin 2016 nga një prokuror i EULEX-it, të pandehurit së fundmi i është shqiptuar një dënim me kusht dhe me gjobë, ndërsa të bashkë-akuzuarit e tjerë, po ashtu zyrtarë komunal të Klinës, janë liruar nga akuza. I pandehuri është ankuar në Gjykatën e Apelit, e cila e ka kthyer rastin për rigjykim.

EULEX-i po ashtu ka monitoruar në numër rastesh të korrupsionit aktiv dhe pasiv, përfshirë disa kundër gjyqtarëve, prokurorëve, zyrtarëve policorë dhe avokatëve.<sup>28</sup> Një nëpunës i Gjykatës Supreme dhe një zyrtar policor janë dënuar më 9 tetor 2019 për ushtrim të ndikimit, ku secilit i është shqiptuar dënim me nga një vit burgim. Një numër i zyrtarëve të nivelit të lartë komunalë dhe qeveritarë janë arrestuar për akuza për korrupsion, përfshirë një drejtor nga Administrata Tatimore.<sup>29</sup> Përkundër progresit të caktuar, mediave dhe shoqërisë civile i është bashkuar komuniteti ndërkombëtar në kritikimin e autoriteteve të Kosovës për mos ndjekjen penale të suksesshme të asnjë zyrtari të profilit të lartë gjatë vitit 2019.<sup>30</sup>

28 Rasti i gjyqtarit Sali Berisha i arrestuar në flagrancë delicto në Pejë; Rasti i gjyqtarit të Departamentit të krimeve të rënda në Gjykatën Themelore të Skenderajt dhe zyrtari policor i arrestuar për keqpërdorim të detyrës, për marrje të ryshfetit dhe ushtrim të ndikimit; rasti PKR.nr.125/17 kundër avokatit Haxhi Çekaj.

29 Rasti i drejtorit komunal të Drenasit i arrestuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare; rasti i kryetarit të komunës së Novobërdës Svetislav Ivanovic dhe ish-kryetarit të komunës së Kaçanikut Xhabir Zharku i arrestuar për raste të ndara për keqpërdorim të pozitës zyrtare me urdhër të gjykatave komunale në Gjilan dhe Ferizaj, respektivisht; Rasti i Safet Krasniqit, drejtor i njësisë për hetime dhe inteligjencë tatimore në Administratën Tatimore të Kosovës, i arrestuar dhe i akuzuar nga PSRK pas ankesës nga punonjësi i ATK Murat Mehmeti. Përmes sigurimit të përfitimeve të paligjshme për veten e tij dhe 120 biznese, i pandehuri i ka shkaktuar buxhetit të shtetit dëm prej mbi 4 miliona euro; rasti kundër ish-ministrit serb të Kosovës Nenad Rikalo (ministria e bujqësisë) dhe shtatë të pandehur të tjerë për keqpërdorim të detyrës zyrtare në lidhje me hartimin e programeve zhvillimore të caktuara.

30 18 nëntor 2019 – Tryeza e rrumbullakët e KLI për “pandëshkueshmërinë e korrupsionit” ka vërejtur se në vitin 2019 asnjë aktakuzë nuk është ngritur për raste të korrupsionit të profilit të lartë; 4 dhjetor 2019 ambasadori britanik i befasuar nga pasurimi i shpejtë i disa qytetarëve të Kosovës; janar 2020 – Indeksi i Transparency International për perceptimin e korrupsionit 2019 e ulë indeksin e Kosovës në botë prej 93 në 101;

EULEX-i po ashtu ka monitoruar *mbrojtjen e zyrtarëve të drejtësisë penale*, duke pas parasysh se një sërë incidentesh të kërcënimeve janë regjistruar kundër prokurorëve. Në një rast të caktuar, një prokuror vendas, i cili ishte duke punuar në hetime për një rast të korrupsionit kundër një zyrtari komunal të njohur, ishte vënë nën presion për ta liruar të dyshuarin nga paraburgimi dhe mori kërcënime të rënda kundër tij dhe familjes së tij. Policia i siguroi prokurorit mbrojtje personale, megjithatë hetimet për kërcënimet ende nuk kanë dhënë ndonjë rezultat. EULEX-i është duke i eksploruar mekanizmat aktualë për sigurimin e mbrojtjes prokurorëve dhe gjyqtarëve nga kërcënimet, presioni apo ndërhyrjet që vijnë prej rasteve të korrupsionit apo rasteve të tjera të rënda të cilat ata i shqyrtojnë. Disa zyrtarë kanë pohuar se ekziston mundësia që të bëhet më shumë për mbrojtjen e tyre sesa masat e sigurisë fizike.

Derisa avancimet legjislative të fundit për *sinjalizimin* janë pranuar me aplaudim të përgjithshëm, legjislacioni sekondar për të garantuar mekanizma të sigurt për sinjalizimin ende nuk është përgatitur, gjë që mund të shpjegojë numrin a paktë të rasteve penale të regjistruara deri më tani, me përjashtim të rastit kundër zyrtarit të Administratës Tatimore të cekur më lartë.

### **Rekomandime:**

- Bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë për rastet e korrupsionit dhe krimeve financiare të rënda të ndjeshmërisë së caktuar, siç janë ato që përfshijnë persona të ekspozuar politikisht, duhet të përmirësohet;
- Ndonëse shumë hetime janë zhvilluar me profesionalizëm, hetimet financiare të ndërlikuara do të përfitonin prej hetimeve më të fuqishme. Jo të gjitha pistat në dispozicion eksploroohen gjithnjë, siç janë skemat kyce financiare dhe regjistrat e korporatave;
- Parimi “ndiq paratë” ka nevojë të fuqizohet me rastin e hetimeve të krimeve të pastrimit të parave dhe krimeve financiare;
- Të fuqizohet Task Forca Anti-Korrupsion e Policisë së Kosovës si palë kyçe në fushën e zbulimit dhe hetimeve kundër korrupsionit.

### **3.2 Krimet nga e drejta ndërkombëtare**

Në gjysmën e dytë të vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020, janë ndërmarrë hapa relevantë për përgatitje për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda nga e drejta penale ndërkombëtare. Me mbështetjen e dhënë nga EULEX-i, Njësia e Policisë së Kosovës për Hetimin e Krimeve të Luftës ka krijuar një bazë të re të dhënave me qëllim të administrimit më të mirë të rasteve të ndërlikuara për të mundësuar kështu analizimin cilësor të rasteve. Një sërë trajnimesh janë zhvilluar dhe zbatuar bashkërisht prej EULEX-it dhe Policisë së Kosovës për 22 hetues për krime të luftës me qëllim të mundësimit të zhvillimit të një sistemi bashkëkohor të menaxhimit të rasteve dhe përmirësimit të kapaciteteve në fushat e përgatitjes, administrimit dhe analizimit të rasteve të krimeve të luftës.

Në bazat e të dhënave janë krijuar pjesë të ndara për rastet e dhunës seksuale të ndërlidhura me konfliktin, dhe për rastet e personave të pagjetur. Në lidhje me rastet e dhunës seksuale të ndërlidhura me konfliktin, identiteti i viktimave është i fshehur dhe qasja u është lejuar një numri të vogël të hetuesve. Databaza mundëson verifikimin e ndërthurtë të dosjeve të krimeve të luftës dhe dosjeve të personave të pagjetur, që pritet se do të lehtëson dhe përshpejton



dukshëm procesin e përgatitjes së rastit. Për t'u theksuar, Njësia për hetimin e krimeve të luftës i ka përfunduar hetimet në shumicën e rasteve aktive të krimeve të luftës kundër Nenad Arsić, Goran Stanišić, Zlatan Krstić/ Destan Shabanaj, që kanë rezultuar me ngritje të aktakuzave në Departamentin Special të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Sa i përket ndjekjes penale, pas përfundimit të hetimeve të rasteve aktive të krimeve të luftës ku të dyshuarit janë vënë në paraburgim, në fillim të vitit 2020, me përjashtim të një rasti, Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë për të gjitha rastet tjera aktive të krimeve të luftës, pra rastet "Rasti Nenad Arsić", "Rasti Goran Stanišić" dhe "Rasti Zlatan Krstić/ Destan Shabanaj". Gjatë muajve të parë të vitit 2020, PSRK-ja i ka indeksuar të gjitha dosjet e tyre të krimeve të luftës dhe si hap i radhës PSRK-ja do t'i ndër-verifikojë ato dosje me dosjet e Njesisë për hetimin e krimeve të luftës në databazën e tyre të re për të siguruar se të gjitha dosjet e rasteve janë të konsoliduara dhe se nuk mungon asnjë informatë.

Një rast i monitoruar i krimeve të luftës ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë kundër Remzi Shalës. Gjykata Themelore në Prizren e ka dënuar atë me 14 vite burgim. Derisa gjendja faktike në këtë aktgjykim është arsytuar mirë, interpretimi ligjor i fakteve ka pasur ca mospërputhshmëri. Këto çështje më vonë janë adresuar deri diku nga Gjykata e Apelit, e cila e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ka zbutur dënimin në 10 vite burgim. Megjithatë, në mars të vitit 2020 Gjykata Supreme e ktheu rastin për rigjykim pas parashtrimit të një kërkesë të suksesshme për mbrojtje të ligjshmërisë.<sup>31</sup>

Një rast tjetër që ka shënuar progres është "Rasti Darko Tasić", i gjykuar nga Gjykata Themelore në Prizren. Për fat të keq ekzistojnë raste ku gjykimi kryesor ka shkuar përtej çdo kufiri kohor të arsyeshëm. Për shembull, në qershor 2018, Gjykata Supreme e ktheu "Rastin Drenica I" në Gjykatën Themelore të Mitrovicës për rigjykim, megjithatë deri më tani asnjë seancë dëgjimore nuk është caktuar.

Duke e pasur parasysh progresin e konsiderueshëm të shënuar nga Policia e Kosovës në lidhje me databazën e krimeve të luftës dhe finalizimin e një numri të hetimeve për raste të krimeve të luftës, Policia e Kosovës duhet përgëzuar. Megjithatë, nuk ka patur progres të mjaftueshëm në hetimin e rasteve të krimeve të luftës që nga PSRK janë kategorizuar si të prioritetit të lartë. Këtë mund ta shpjegojë fakti se Policisë së Kosovës i është dashur kohë për krijimin e databazës së re dhe për digjitalizimin e të gjitha provave. Meqë provat në lidhje me shumicën e rasteve të prioritetit të lartë tani më janë digjitalizuar plotësisht dhe janë futur në bazën e të dhënave, Policisë së Kosovës i duhet bërë përpjekje për vazhdimin e hetimeve dhe analizimin e të gjitha rasteve të krimeve të luftës të kategorizuara me prioritet të lartë.

Departamenti për Krime të Luftës në PSRK, *ndonëse me numër të pamjaftueshëm të stafit*, ka shënuar progres domethënës dhe ka finalizuar pothuajse të gjitha rastet e tij aktive të krimeve të luftës qoftë përmes ngritjes së aktakuzave apo përmes ndërprerjes së hetimeve aty ku janë grumbulluar prova që dëshmojnë pafajësinë e të dyshuarit (dyshuarve). Edhe pse bashkëpunimi mes Departamentit për krime të luftës në PSRK dhe policisë është përmirësuar, ende ka vend për zhvillim të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.

<sup>31</sup> Mbrojtja e ligjshmërisë është mjet juridik i jashtëzakonshëm i cili mund të kërkohe kundër ndonjë vendimi gjyqësor të formës së prerë, apo kundër procedurave gjyqësore që kanë paraprirë nxjerrjen e atij vendimi, në bazë të një shkelje të pretenduar të Kodit Penal të Kosovës apo të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Një sfidë domethënëse në gjykimin e krimeve të luftës është mungesa e bashkëpunimit rajonal të ndërsjellë, kryesisht me Serbinë, çka i pengon më tej hetimet e rasteve të krimeve të luftës të identifikuar të prioritetit të lartë, meqë shumë dëshmitarë dhe të dyshuar banojnë në Serbi.

### **Rekomandime:**

- Policia e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për vazhdimin e hetimeve dhe analizimin e të gjitha rasteve të krimeve të luftës të kategorizuara të prioritetit të lartë;
- Bashkëpunimi mes Departamentit të krimeve të luftës në PSRK dhe Policisë së Kosovës ka nevojë të përmirësohet;
- Departamenti i krimeve të luftës në PSRK duhet të zgjerohet;
- Inkurajohen autoritetet e Kosovës që të kërkojnë mënyra për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e rasteve të krimeve të luftës me prioritet të lartë, në veçanti me Serbinë, ku banojnë shumë të dyshuar dhe dëshmitarë.

### **3.3 Privatizimi dhe likuidimi**

Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 30 maj 2019 dhe hyri në fuqi më 12 korrik 2019. Me miratimin e tij Dhoma e Posaçme u bë plotësisht operacionale. Rrjedhimisht, me ligjin e ri janë lejuar gjykimet e rasteve të privatizimit gjë që nuk ka qenë e mundur që nga qershori 2018 kur gjyqtarët përkatës të EULEX-it përfunduan punën në gjykatë.

Miratimi i ligjit të ri e bëri të nevojshëm finalizimin e procesit të rekrutimit të gjyqtarëve të Dhomës së Posaçme për t'i zëvendësuar shtatë gjyqtarët e EULEX-it, të cilët përfunduan punën në gjykatë në qershor 2018, dhe dy gjyqtarët vendas të cilët do të pensionoheshin shpejt. Konkursi u shpallë për shtatë pozita, por u desh të përsëritej për shkak të numrit të vogël të kandidatëve që i plotësonin kriteret për të pasur tetë vite përvojë si gjyqtar i Gjykatës Supreme. Këshilli Gjyqësor i Kosovës vendosi të anulojë konkursin, duke pasur parasysh se, për shkak të numrit të vogël të kandidatëve, konkursi nuk ishte i vlefshëm.

Konkursi u përsërit më 26 qershor 2019, ku kërkohej përvoja e njëjtë prej tetë viteve si gjyqtar në Gjykatën Supreme. Ky kriter i lartë i përvojës që pengës për proces të suksesshëm të përzgjedhjes. Rrjedhimisht, vetëm katër gjyqtarë u emëruan më 24 dhjetor 2019 prej pesë kandidatëve të propozuar për emërim. Gjyqtarët e ri iu bashkuan Dhomës së Posaçme në janar të vitit 2020.

Në Dhomën e Posaçme aktualisht punojnë 15 gjyqtarë. Megjithatë, numri i zyrtarëve ligjorë vazhdon të jetë i pamjaftueshëm për shqyrtimin e më shumë se 22.000 rasteve të grumbulluara. Duke e pasur parasysh normën aktuale të zgjidhjes prej 250 raste në muaj, zgjidhja e rasteve të grumbulluara sigurisht se do të merr më shumë se dhjetë vite kohë.

Statistikat tregojnë për rritje të caktuar të numrit të rasteve të zgjidhura pas miratimit të ligjit të ri. Megjithatë, duhet pasur parasysh se këto statistika mund të jenë pjesërisht të fryra meqë shumica e rasteve të zgjidhura mund të kenë qenë veçse të përgatitura gjatë periudhës kur ligji i ri për Dhomën e Posaçme ende nuk ka qenë në fuqi.

EULEX vuri re se në numri i seancave dëgjimore të mbajtura në Dhomën e Posaçme nuk ka qenë i shumtë, me një përjashtim që vlen të theksohet ku një gjyqtar ka caktuar shumë seanca dëgjimore për të finalizuar rastin Fabrika e Amortizatorëve me 511 paditës në më pak se dy muaj.

Është monitoruar se mjetet e veçanta në dispozicion në lidhje me kërkesat masive pothuajse nuk janë përdorur fare. Një arsye e identifikuar për këtë mospërdorim është se shumica e rasteve të DhPGjS janë ricaktuar mes të gjithë gjyqtarëve, ndërsa në të kaluarën Dhoma e Posaçme ka pasur një sërë të trupave gjyquese të specializuara. Derisa ricaktimi i rasteve mes të gjithë gjyqtarëve është lëvizje pozitive, meqë ai mundëson një prioritizim më të mirë të rasteve të vjetra, ai po ashtu ka efekt negativ, meqë nganjëherë kërkesat masive u caktohen gjyqtarëve me pak apo fare përvojë në këtë fushë specifike, gjë që rezulton me vonesa dhe nganjëherë humbje të punës përgatitore të rëndësishme që veçse është kryer. Megjithatë, shabllonët për kërkesat masive të përgatitura nga EULEX në të kaluarën janë duke u azhurnuar për të reflektuar ndryshimet e ligjit të ri për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe me shpresë do të jenë të dobishme për Dhomën në të ardhmen e afërt. Zgjidhja e rasteve të kërkesave masive është në veçanti relevante për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara në mënyrë të shpejtë dhe efikase. Një zhvillim pozitiv vendimi i gjyqtarit mbikëqyrës për të ricaktuar dy punonjës nga shkrimorja për të ndihmuar veçanërisht për rastet e privatizimit që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shoqërore me numër të madh të kërkesave masive.

#### **Rekomandime:**

- Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme duhet të miratojë një strategji afatgjate për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara. Kjo strategji duhet, për shembull, të caktojë kritere të prioriteteve dhe të identifikojë burimet e nevojshme për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara;
- Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme duhet të fillojë me përdorimin e formularëve shabllon për trajtimin e kërkesave masive dhe të caktojë zyrtarë ligjorë për kryerjen e punës përgatitore përkatëse;
- Punësimi i zyrtarëve shtesë për mbështetje ligjore duhet të konsiderohet;
- Kriteret për aplikim për pozitën e gjyqtarit në DhPGjS (tetë vite përvojë pune si gjyqtar në Gjykatën Supreme) duhet të ulet, së paku përkohësisht, me qëllim të tërheqjes së një numri më të madh të kandidatëve që i plotësojnë kushtet.

### ***3.4 Paneli i ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës / të drejtat pronësore***

Pas datës 14 qershor 2018, kur EULEX-i përfundoi mandatin e tij ekzekutiv dhe gjyqtarët ndërkombëtarë përfunduan punën në Panelin e Ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronës (PA AKP) në Gjykatën Supreme të Kosovës, rastet nuk kanë mundur të gjykohen më nga ai Panel. Zgjidhja për këtë ngërç u gjet nga Kryetari i Gjykatës Supreme i cili, më 28 gusht 2018, vendosi të caktojë dy gjyqtarë vendas joshumicë për t'u ulur në PA AKP me rotacion. Kjo i mundësoi Panelit që të vazhdonte me gjykimin e rasteve dhe të zvogëlonte numrin e ankesave që pritin të gjykoheshin.

Paneli më parë mbante seanca të rregullta javore me rreth katër raste të caktuara për vendosje. Në periudhën mes shtatorit 2019 dhe mesit të marsit 2020, për 44 raste janë dhenë vendime, duke e lënë kështu numrin e rasteve të grumbulluara në 39 ankesa në pritje të vendosjes.

EULEX-i ka monitoruar një numër të rasteve civile në lidhje me të drejtat pronësore, temë e të cilave ishin çështjet si përcaktimi i pronësisë, uzurpimi i paligjshëm, kompensimi, anulimi i kontratave, transaksionet mashtruese, legalizimi i dokumenteve të rreme dhe dëbimet. Problemi kryesor i identifikuar në këto raste është kohëzgjatja e tepërt e procedurës për shkak të arsyeve të ndryshme.

Disa shembuj:

- Një seancë dëgjimore për një rast është caktuar më shumë se pesë vite e gjysmë nga koha e parashtrimit të padisë;
- Përgjigja në padi është dorëzuar pas rreth 11 viteve dhe dy vite më vonë rasti është transferuar në një gjykatë tjetër;
- Një rast, përgjigja në padi është dorëzuar pas rreth katër viteve;
- Një rast i nisur në vitin 2002 është kthyer për rigjykim nga ana e Gjykatës së Apelit në vitin 2009. Deri në momentin e përpilimit të këtij raporti, rigjykimi nuk ka filluar;
- Në shumë raste gjyqtarët ndërrojnë pozita dhe kalojnë në departamente/gjykata të tjera dhe rastet mbesin në pritje për kohë të gjata deri sa të caktohen apo të shqyrtohen.

Nga ana pozitive, një prej rasteve penale të monitoruara në lidhje me të drejtat pronësore – një transaksion mashtrues dhe legalizim i dokumenteve të falsifikuara – është finalizuar dhe gjykata e ka dënuar të akuzuarin me dënim me burg pa kusht.

Nga monitorimet po ashtu është vërejtur se seancat dëgjimore gjyqësore shpesh shtyhen për ditë të tjera pa asnjë arsye bindëse. Për shembull, në një prej rasteve të monitoruara dëshmitarët ishin ftuar për të dëshmuar tri herë dhe tri herë gjykata nuk i kishte pyetur për arsye që nuk ndërlidheshin me vet dëshmitarët. Një problem serioz i monitoruar që ndikon tek procedurat efektive dhe me kohë ka të bëjë me përkthimin e dokumenteve. Obligimi i gjykatës që palës t'ia dorëzojë dokumente në gjuhën që ajo e kupton nuk mund të konsiderohet si i përmbushur, meqë sipas stafit të gjykatave dhe gjyqtarëve, në gjykata nuk ka interpretë/përkthyes të mjaftueshëm për përkthim, për shembull të vendimeve procedurale. Është vërejtur se në disa raste vendimi procedural ka qëndruar joaktiv për muaj me radhë për shkak të vonësive në përkthim çka ka pasur ndikim mbi të drejtat e palëve meqë i pengon ata nga ndërmarrja e veprimeve të mëtejme. Një aspekt tjetër që ka ndikim mbi procedurat është nevoja për të kërkuar ekspertizë: në disa raste eksperti e ka mbajtur dosjen gjyqësore për më shumë se një vit pa e dhënë ekspertizën dhe pa u disiplinuar nga gjykata.

Si përmbledhje, për shkak të zgjatjes së tepruar e procedurave në raste civile nuk mund të konsiderohet se e drejta për gjykim të drejtë garantohet nga gjyqësori. Pezullimet e gjata në raste të caktuara shkaktojnë tek shoqëria bindje për mungesë të qasjes në mjete juridike. Në disa prej rasteve të monitoruara, paditësit fillestarë kanë pritur më kot për zgjidhjen e rasteve

të tyre, dhe kanë vdekur pa e arritur zgjidhjen e kontestit nga ana e gjykatës. Rrjedhimisht, trashëgimtarët e atyre paditësve e kanë mundësinë e hyrjes në procedurë, por vendimet në atë drejtim ndonëse të nxjerra, të papërkthyer, nuk i dërgohen familjarëve të paditësve të vdekur. Kjo të qon në përfundim se rrethi vicioz i problemeve me të cilat përballet gjyqësori në Kosovë sa i përket rasteve civile i prekë edhe familjarët. Rrjedhimisht, e drejta për mbrojtjen e pronës shkelet për shkak të proceseve gjyqësore të ngadalta dhe joefikase.<sup>32</sup>

### Rekomandime:

- Menaxhmenti i gjykatës duhet të ndërmerr hapat e nevojshëm për shqyrtimin e problemit të rasteve civile të grumbulluara dhe caktimin e rasteve tek gjyqtarët, si dhe të bëjë monitorim të rregullt të aktiviteteve të ndërmarra për rastet;
- Gjyqtarët e lëndëve civile duhet bërë me dije se zgjatja e paarsyeshme e procedurave prekë të drejtën për gjykim të drejtë dhe se në ligjin për procedurën kontestimore ekzistojnë dispozita të cilat mund të aplikohen për shkurtimin e zgjatjes së procedurës.

### 3.5 Krimet e urrejtjes

Marrëveshja e Bashkëpunimit për Adresimin e Krimeve të Urrejtjes në Kosovë është miratuar pothuajse dy vite më parë. Ajo përmban dispozita dhe mekanizma që kanë për qëllim avancimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërinstucional mes Policisë së Kosovës, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Zyrës së Kryeprokurorit të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës me qëllim të adresimit të krimeve të urrejtjes në një mënyrë më të mirë dhe më të strukturuar. Deri më tani zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit është larg nga të qenit i kënaqshëm. Caktimi i koordinatorëve për krimet e urrejtjes nëpër rajonet e Kosovës, i cili është një prej mekanizmave të paraparë në Marrëveshje, rezultoi me sensibilizim të shtuar për aspektet specifike të procesimit të këtyre llojeve të krimeve, në veçanti në rajonin e Prishtinës, por pothuajse nuk ka patur fare progres në zbatimin e mekanizmave të tjerë të paraparë në marrëveshjen, siç është themelimi dhe funksionimi i një grupi punues apo krijimi i një databaze të standardizuar të të dhënave të ndara rreth krimeve të urrejtjes.

Si pjesë e përgjegjësive të Policisë së Kosovës të përcaktuara në marrëveshjen e bashkëpunimit, janë bërë ndryshime në raportin policor të incidentit, dhe formulari i ri e përmban një rubrikë specifike '*krim i urrejtjes*' për identifikim e rasteve potenciale të kësaj fushe. Kjo po ashtu shërben edhe për grumbullimin e statistikave të duhura rreth motivimit të animit dhe indikatorëve të animit me qëllim të themelimit të një databaze të standardizuar me të dhëna të ndara rreth krimeve të urrejtjes. EULEX-i ende nuk ka mundur të verifikojë ndikimin e kësaj mase në praktikë por do t'i inkurajojë institucionet kompetente që të vazhdojnë me përdorimin e këtyre formularëve dhe të japin informata kthyesë mbi atë se nëse këto ndryshime kanë ndikim pozitiv në aspektin e identifikimit dhe procesimit më të mirë të rasteve ku komponenti i urrejtjes është i pranishëm.

Sipas organizatave të shoqërisë civile, diskriminimi dhe dhuna kundër minoriteteve në Kosovë ka vazhduar të jetë çështje për shqetësim, në veçanti për komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian, dhe femrat në veçanti, të cilët vazhdojnë të kenë vështirësi në të gjitha sferat e jetës, nga kujdesi shëndetësor, asistencë sociale, përfaqësimi qytetar dhe arsimimi. OJQ të ndryshme rrome kanë shprehur shqetësim rreth mosveprimeve të Qeverisë dhe mungesës së burimeve të ndara për këto komunitete.

<sup>32</sup> Neni 1 i Protokollit 1 të KEDNj.

Dy raste kriminale që kanë përfshirë viktima rome dhe ashkalinje janë monitoruar nga EULEX-i, një në lidhje me një femër rome e cila ishte sulmuar në Lipjan dhe Ferizaj, dhe rasti tjetër lidhur me dhunimin seksual dhe vrasjen e një fëmije nëntëvjeçar në Fushë Kosovë. Këto raste kanë nxitur hetime ex-officio nga Zyra e Avokatit të Popullit, i cili dha dy raporte speciale, më datat 6 dhe 9 dhjetor 2019 respektivisht, me një analizë faktike dhe juridike për rastet dhe me rekomandime gjithashtu. Vlen të theksohet se disa OJQ që punojnë me komunitete të cënueshme kanë shprehur pakënaqësi për faktin se nuk ishin konsultuar para publikimit të raportit.

Mosdurimi drejt personave LGBTI është ende i përhapur dhe shumë persona LGBTI vazhdojnë të jenë të rrezikuar nga diskriminimi dhe dhuna. Aktivistë për të drejtat e njeriut ende kërcënohen publikisht dhe nëpër platforma të mediave sociale. EULEX-i është duke i monitoruar rastet që aktualisht janë në fazë të hetimeve policore.

EULEX-i ka vënë re dy zhvillime inkurajuese në lidhje me personat transgjinnor:

- Më 24 tetor 2019, Gjykata Themelore e Prishtinës pranoi ndryshimin e emrit të Blert Morinës. Vendimi e bëri të qartë se Departamenti i Përgjithshëm i Administratës në Komunën e Gjakovës duhet të pranojë që një ndryshim i emrit dhe i gjinisë të regjistrohet në regjistrat përkatës të gjendjes civile. Blert Morina është pjesëtari i parë i komunitetit transgjinnor të Kosovës që ka iniciuar rast për njohje institucionale të ndryshimit gjinnor në Kosovë;
- Gjykata e Apelit e Kosovës, më 2 gusht 2019, zyrtarisht miratoi kërkesën e një qytetari transgjinnor për ndryshimin e emrit dhe shënjesit të gjinisë në regjistrin e gjendjes civile.

Sa i përket hetimeve të zhvilluara për një sërë incidentesh që i kanë shënjestruar lokacionet fetare dhe varrezat e të cilat janë raportuar në vitin 2019, nuk është shënuar ndonjë rezultat madhor, përkatësisht rasti i sulmit ndaj kishës ortodokse serbe në komunën e Prizrenit, sulmi mbi një xhami në komunën e Ferizajit, dëmtimi i 19 gurëve të varreve në një varrezë të serbëve të Kosovës në Lipjan dhe përdhosja e 15 gurëve të varreve të myslimanëve në Prishtinë. Në lidhje me grafitin nëpër shkolla apo vende publike me shenja ushtarake apo propaganda politike, hetimet duhet të përcaktojnë nëse këto akte përmbajnë elemente të krimeve të urrejtjes.

EULEX-i ka monitoruar se incidentet në lidhje me lokacionet fetare, varrezat dhe grafitit fyese shpesh raportohen kundrejt kryerësve të panjohur dhe në shumicën e rasteve mbesin të tilla saqë hetimet e incidenteve të tilla nuk prioritizohen.

### **Rekomandime:**

- Palët e Marrëveshjes së bashkëpunimit për adresimin e krimeve të urrejtjes në Kosovë (Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Kryeprokurorit, Policia e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës) duhet të bëjnë përpjekje për zbatimin e dispozitave dhe për themelimin e mekanizmave të paraparë në marrëveshjen për të siguruar bashkëpunimin dhe bashkërendimin institucional në këtë fushë;
- Në veçanti, nevojitet më shumë sensibilizim për mundësinë që ndonjë krim të jetë i motivuar nga urrejtja apo animi;
- Incidentet që përfshijnë lokacionet fetare, varrezat dhe grafitit fyese duhet të hetohen më fuqishëm;

- Nevojiten më shumë përpjekje për luftimin e mosdurimit ndaj personave LGBTI, meqë shumë prej tyre vazhdojnë të jenë të rrezikuar nga diskriminimi dhe dhuna;

### **3.6 Dhuna në bazë gjinore**

Në shkurt 2019, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka dhënë vendim pozitiv për kërkesën e grupit parlamentar të grave për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës për njohjen e aplikueshmërisë së drejtpërdrejtë të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, e njohur edhe si Konventa e Stambollit. Gjykata konstatoi se ndryshimi i propozuar do të fuqizonte zotimin e Kosovës drejt mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në prill 2019, Kodi i ri Penal i Kosovës hyri në fuqi. Ky Kod e kategorizon dhunën në familje si vepër penale dhe përcakton se fakti që një vepër është kryer brenda marrëdhënies familjare duhet të konsiderohet si faktor rëndues. Pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal, një grup punues u themelua për përgatitjen e amendamenteve për Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje. Ligji i propozuar për amendamentin ka për qëllim rregullimin e pozitës dhe qëndrueshmërisë financiare të strehimoreve për viktimat e dhunës në familje dhe arritjen e njohjes formale të pozitës së Koordinatorit nacional për dhunën në familje dhe të mekanizmave komunal për dhunën në familje. Ligji i ri gjithashtu duhet të zgjerojë kompetencën e stacioneve policore për të nxjerrë urdhra për mbrojtje emergjente. Përkundër përpjekjeve të avokimit të bëra nga shoqëria civile dhe akterët ndërkombëtarë, nuk është gjetur zgjidhje e qëndrueshme për gjendjen financiare të strehimoreve.

Një zhvillim pozitiv i vitit 2019 ka qenë krijimi i bazës së të dhënave për rastet e dhunës në familje. Institucionet relevante janë të obliguara që të azhurnojnë databazën me informatat e nevojshme nga nivelet qendrore dhe komunale, duke mundësuar kështu një monitorim më të mirë dhe, mbi të gjitha ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të dhunës në familje. Përderisa Policia e Kosovës ka qenë në krye të proceseve për futjen e të dhënave në bazën e të dhënave, institucionet e tjera (p.sh. prokuroritë, gjykatat dhe qendrat për mirëqenie sociale) ende kanë mbetur prapa, pjesërisht për shkak të mungesës së trajnimeve dhe mungesës së softuerit.

### **Trajtimi i rasteve të dhunës në bazë gjinore**

Në nivel të policisë, përmirësime domethënëse janë vërejtur tek referimi i saktë i rasteve me pretendime të dhunës seksuale tek zinxhiri i ofruesve të shërbimeve, në veçanti tek Instituti i Mjekësisë Ligjore për ruajtjen me kohë të provave biologjike. Aspektet e tjera vazhdojnë të jenë problematike, siç është niveli i komunikimit dhe bashkëpunimit mes policisë dhe prokurorisë dhe mungesa e burimeve, në veçanti personeli i trajnuar mirë. Policia zakonisht angazhon zyrtarë avokues të viktimave dhe zyrtarë nga Qendra për mirëqenie Sociale, por ka mungesë të njohurive efektive në lidhje me përdorimin e qasjes gjithëpërfshirëse të bazuar në viktimën në lidhje e intervistimin e viktimave, në veçanti viktimave të mitura. Zyrtarët policorë ende kanë mungesë të burimeve dhe trajnimeve të duhura për grumbullimin e provave teknologjike (p.sh. përgjimi i bisedave dhe porosive telefonike) të cilat mund të jenë jetike për hetimin e rasteve të dhunës në bazë gjinore, në veçanti rasteve të veprave seksuale.

## **Praktikat e dënimit në rastet e dhunës në familje**

Siç u cek më lartë, Kodi i ri Penal i Kosovës ka shënuar hap monumental me kriminalizimin e dhunës në familje dhe me përcaktimin e faktorit rëndues për çdo vepër penale që kryhen brenda marrëdhënies familjare. Konventat ndërkombëtare, si Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW), e cila është e aplikueshme në Kosovë, dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, si dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, theksojnë obligimin e shtetit për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga dhuna në baza gjinore dhe për frenimin dhe dënimin e kryerësve.

Tek rastet e monitoruara nga EULEX-i, dënime me burgim të gjata janë shqiptuar për raste të vrasjeve të rënda, ndërsa në rastet e kërcënimeve, ku elementi i posedimit të paautorizuar të armës ka qenë i pranishëm, burgimet me 180 ditë të zëvendësuara me gjobë janë shqiptuar. Për rastet e lëndimeve trupore të lehta dhe sulmeve, dënime me kusht prej 150 apo 180 ditëve burgim me periudhë të verifikimit prej një viti janë shqiptuar. Dënime me kusht janë shqiptuar në të gjitha rastet e shkeljes së urdhrave për mbrojtje.

Të gjitha rastet e kërcënimeve, lëndimeve trupore (të rënda ose të lehta) dhe sulmeve janë konsideruar dhe dënuar në lidhje me nenin 248.2 të Kodit të ri Penal, pra si *vepra rënduese*.

Siç mund të vërehet, derisa dënime të gjata janë shqiptuar në rastet e vrasjeve të rënda, veprat e tjera të rënda ose kanë marrë dënime të ulëta, nganjëherë edhe nën shtrirjen e paraparë, ose dënime me kusht me periudhën minimale të verifikimit prej një viti, ndonëse Kodi Penal përcakton periudha të verifikimit deri në dy vite (shih nenin 48 (2) të Kodit Penal). Rrethanat rënduese kështu që pothuajse fare nuk janë marrë parasysh, apo janë kundërpeshuar plotësisht me faktorët lehtësues, ndërsa arsyetimi i hollësishëm për ato dënime rrallë është dhenë, ku gjykatat shpesh përdorin formulimin ‘gjykata e konsideron dënimin të drejtë’, pa iu referuar fare rrethanave që janë marrë më shumë parasysh se të tjera. Më tej, në shumë raste të dhunës në familje që përfshijnë përdorimin apo posedimin e armëve, ky element shpesh nuk konsiderohet si faktor rëndues, ndonëse e përcaktuar me Kodin Penal, dhe me rastin e dënimit të veprave të posedimit të armëve, gjykatat kryesisht zgjedhin shqiptimin e lehtë të gjobës.

### **Rekomandime:**

- Duhet të bëhen përpjekje për miratimin e Ligjit të amandamentuar për mbrojtje nga dhuna në familje; në këtë proces duhet të merren parasysh propozimet dhe komentet që vijnë nga aktorët relevantë të shoqërisë civile; vëmendje e posaçme duhet t’i kushtohet sigurimit të pozitës dhe qëndrueshmërisë financiare të strehimoreve;
- Të gjitha institucionet përkatëse duhet të kontribuojnë në databazën me rastet e dhunës në familje, siç parashihet; burimet teknike dhe njerëzore të nevojshme për përmbushjen e kësaj detyre duhet të vihen në dispozicion;
- Komunikimi dhe bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë duhet të përmirësohet;



- Policia duhet të jetë më mirë e trajnuar dhe e pajisur për të patur mundësinë e zbatimit të qasjes gjithëpërfshirëse të bazuar në viktimën gjatë intervistimit të viktimës dhe grumbullimit adekuat të provave teknike;
- Dispozitat e Kodit Penal të ri rreth dhunës në familje duhet të merren plotësisht parasysh nga gjykatat; kjo vlen në veçanti për faktorin rëndues të veprës penale të kryer në ambiente familjare për sigurimin e arsyesimit të detajuar për dënimet në të cilat faktorët rëndues kundërpeshohen nga faktorët lehtësues.

Shtojca I – Lista me rekomandime

Shtojca II – Lista e rasteve të monitoruara dhe të referuara

## **SHTOJCA I – LISTA ME REKOMANDIME**

### **Monitorimi sistemik**

#### **Seancat dëgjimore produktive vs. joproductive**

- Llogaridhënia në drejtim të menaxhimit të gjykatës duhet të rritet;
- Gjyqtarët duhet të raportojnë rregullisht për numrin e seancave joproductive dhe çfarë masash janë ndërmarrë, nëse ka. Nëse nuk janë ndërmarrë masa, ndërsa kjo do të kishte qenë e mundur, duhet të jepet një arsye;
- Prokurorët duhet të mbahen përgjegjës nëse ata janë shkak për një seancë joproductive, për shembull duke mos u përgatitur apo duke mos u paraqitur në seancë pa arsye të justifikueshme;
- Gjyqtarët duhet t'i aplikojnë masat ndëshkuese dhe disiplinore që i kanë në dispozicion sipas Kodit të Procedurës Penale.

#### **Disa përparime në ritmin e gjykimit të rasteve të profilit të lartë**

- Gjykatat duhet të sigurojnë që gjykimet të mos shtyhen pa arsye.

#### **Funksionimi i Departamenti Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës**

- Të rritet numri i gjyqtarëve në Departamentin Special në shkallën e parë dhe nivelin e apelit në përputhje me dispozitat ligjore për përfshirjen etnike siç parashihet në ligj dhe në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit;
- Të rekrutohet personeli mbështetës shtesë si bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë;
- Të instalohen pajisjet e domosdoshme për të mundësuar pyetjen e dëshmitarëve nën masa mbrojtëse në Pallatin e Drejtësisë në Prishtinë;
- Të rritet numri i përkthyesve për gjuhët shqip/serbisht.

#### **Ndjekja e rasteve të terrorizmit**

- Duke marrë parasysh ndarjen e shpejtë të drejtësisë në rastet e terrorizmit të cilat janë monitoruar, si dhe dënimet përgjithësisht të ulëta/me kusht, duket se barra komplekse dhe e vështirë e menaxhimit të rreziqeve të mundshme të ardhshme që lidhen me të kthyerit mbi mbi shpatullat e policisë. Rezultati i kësaj duhet të monitorohet për së afërmi nga institucionet e Kosovës për sundim të ligjit.

#### **Politika për rigjykimet në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovë**

- Gjykata e Apelit duhet të shfrytëzojë më mirë mundësinë e dhenë nga Kodi i Procedurës Penale i Kosovës për të mbajtur seanca dëgjimore, për të marrë prova të reja apo për të konfirmuar provat ekzistuese, me qëllim të përcaktimit dhe vlerësimit të duhur të fakteve materiale, me qëllim të mënjanimin të anulimit të panevojshëm të aktgjykimeve dhe kthimit të rasteve në rigjykim;

- Drafti i ri i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përkufizon procedurën e rigjyimit si diçka e jashtëzakonshme, që duhet të përdoret vetëm në raste specifike. Kjo duhet të jetë nxitje shtesë për gjykatat e apelit që ato të përmbahen nga kthimi i panevojshëm i rasteve në rigjykim;
- Cilësia e aktgjyqimeve duhet të përmirësohet, me fokus specifik në nevojën për harmonizim më të mirë të dispozitivëve dhe pjesës së arsyetimit të aktgjyqimeve.

### **Caktimi i rasteve në procedurat e rigjyimit**

- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet ta vlerësojë praktikën aktuale gjyqësore dhe implikimet e saj dhe nëse konsiderohet e duhur, të vendos që ta nxjerrë një vendim ose interpretim udhëzues, ose përndryshe të ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore me qëllim që të sigurojë një interpretim dhe zbatim konsistent të dispozitave përkatëse, për të siguruar që të ruhet dhe konsolidohet paanshmëria dhe pavarësia e gjyqësori.

### **Pyetjet e tërthorta**

- Gjyqtarët duhet të jenë më të vendosur në mbrojtjen e zbatimit të ligjshëm të rregullave për pyetjet e tërthorta gjatë shqyrtimeve kryesore, por duhet nënvizuar se edhe palët e kanë përgjegjësinë e tyre në zbatimin e duhur të pyetjeve të tërthorta.
- Iniciativat për ta përmirësuar cilësinë e pyetjeve të tërthorta në shqyrtimet kryesore mund të përfshijnë:
- Përgatitjen e kurseve në internet me udhëzime dhe këshilla praktike ad-hoc në lidhje me pyetjet e tërthorta për praktikuesit ligjorë, të zhvilluara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe/ose Oda e Avokatëve të Kosovës, si dhe të jenë në dispozicion të profesionistëve ligjorë pa pagesë;
- botimi i një manuali për pyetjet e tërthorta për praktikuesit e ligjit të shkruar nga një gamë e gjerë profesionistësh ligjorë, kryesisht nga ata që përfshihen aktivisht në gjykime penale (p.sh. gjyqtarë, prokurorë, avokatë mbrojtës);
- zbatimi i aktiviteteve me qëllim të rritjes së vetëdijesimit për pyetjet e tërthorta (p.sh. theksimi i ligjërimit për pyetjet e tërthorta në fakultetet juridike, rritja e numrit të pyetjeve të drejtuara në pyetjet e tërthorta gjatë provimeve të jurisprudencës; organizimi i garave me gjykime të simuluar për studentët e drejtësisë dhe avokatët në moshë të re.)

### **Shpallja e aktgjyqimeve për raste penale në shkallë të parë**

- Ekziston nevoja për trajnime më efektive të gjyqtarëve. Diskutimet në forume profesionale midis gjyqtarëve të shkallëve të ndryshme gjithashtu mund ta adresojnë në mënyrë efektive këtë shqetësim.

### **Paraburgimet**

- Kërkesat e prokurorisë për caktimin e paraburgimit dhe vendimet përkatëse të gjykatës duhet të arsyetohen me fakte konkrete në një mënyrë që i pandehuri të jetë në gjendje ta kuptojë vendimin;
- Në rast se plotësohen kushtet për caktimin e një mase sigurie, duhet të urdhërohet masa më e butë kurse paraburgimi duhet të jetë mjeti i fundit;
- Me rëndësi është se duhet të merret parasysh që zyrtarët e Shërbimit Korrektues të Kosovës

janë paraburgosur jo vetëm në të njëjtin objekt në të cilin punojnë, por në të vërtetë në qelitë me të burgosurit të cilët ata duhej t'i ruanin më parë. Kjo situatë është potencialisht armiqësore. Ajo paraqet rrezik për sigurinë e zyrtarëve korrektues dhe për më tepër mund të ketë efekt psikologjik mbi ta. Në një rast, fillimisht oficerët korrektues kishin madje të veshura uniformat e tyre zyrtare derisa po paraburgoseshin.

### **Konfiskimi dhe konfiskimi i përkohshëm i pasurisë**

- Të fillohet zbatimi i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë dhe të përdoret më shpesh mundësia e shitjes së pasurive.

### **Monitorimi tematik**

#### **Anti-korrupsioni**

- Bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë për rastet e korrupsionit dhe krimeve financiare të rënda të ndjeshmërisë së caktuar, siç janë ato që përfshijnë persona të ekspozuar politikisht, duhet të përmirësohet;
- Ndonëse shumë hetime janë zhvilluar me profesionalizëm, hetimet financiare të ndërlikuara do të përfitonin prej hetimeve më të fuqishme. Jo të gjitha pistat në dispozicion eksplorohej gjithnjë, siç janë skemat kyce financiare dhe regjistrat e korporatave;
- Parimi “ndiq paratë” ka nevojë të fuqizohet me rastin e hetimeve të krimeve të pastrimit të parave dhe krimeve financiare;
- Të fuqizohet Task Forca Anti-Korrupsion e Policisë së Kosovës si palë kyçe në fushën e zbulimit dhe hetimeve kundër korrupsionit.

#### **Krimet nga e drejta ndërkombëtare**

- Policia e Kosovës duhet të bëjë përpjekje për vazhdimin e hetimeve dhe analizimin e të gjitha rasteve të krimeve të luftës të kategorizuara të prioritetit të lartë;
- Bashkëpunimi mes Departamentit të krimeve të luftës në PSRK dhe Policisë së Kosovës ka nevojë të përmirësohet;
- Departamenti i krimeve të luftës në PSRK duhet të zgjerohet;
- Inkurajohen autoritetet e Kosovës që të kërkojnë mënyra për përmirësimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e rasteve të krimeve të luftës me prioritet të lartë, në veçanti me Serbinë, ku banojnë shumë të dyshuar dhe dëshmitarë.

#### **Privatizimi dhe likuidimi**

- Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme duhet të miratojë një strategji afatgjate për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara. Kjo strategji duhet, për shembull, të caktojë kritere të prioriteteve dhe të identifikojë burimet e nevojshme për zgjidhjen e rasteve të grumbulluara;
- Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme duhet të fillojë me përdorimin e formularëve shabllon për trajtimin e kërkesave masive dhe të caktojë zyrtarë ligjorë për kryerjen e punës përgatitore përkatëse;
- Punësimi i zyrtarëve shtesë për mbështetje ligjore duhet të konsiderohet;

- Kriteret për aplikim për pozitën e gjyqtarit në DhPGjS (tetë vite përvojë pune si gjyqtar në Gjykatën Supreme) duhet të ulet, së paku përkohësisht, me qëllim të tërheqjes së një numri më të madh të kandidatëve që i plotësojnë kushtet.

### **Paneli i ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës**

- Menaxhmenti i gjykatës duhet të ndërmer hapat e nevojshëm për shqyrtimin e problemit të rasteve civile të grumbulluara dhe caktimin e rasteve tek gjyqtarët, si dhe të bëjë monitorim të rregullt të aktiviteteve të ndërmarra për rastet;
- Gjyqtarët e lëndëve civile duhet bërë me dije se zgjatja e paarsyeshme e procedurave prekë të drejtën për gjykim të drejtë dhe se në ligjin për procedurën kontestimore ekzistojnë dispozita të cilat mund të aplikohen për shkurtimin e zgjatjes së procedurës.

### **Krimet e urrejtjes**

- Palët e Marrëveshjes së bashkëpunimit për adresimin e krimeve të urrejtjes në Kosovë (Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Kryeprokurorit, Policia e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës) duhet të bëjnë përpjekje për zbatimin e dispozitave dhe për themelimin e mekanizmave të paraparë në marrëveshjen për të siguruar bashkëpunimin dhe bashkërendimin institucional në këtë fushë;
- Në veçanti, nevojitet më shumë sensibilizim për mundësinë që ndonjë krim të jetë i motivuar nga urrejtja apo animi;
- Incidentet që përfshijnë lokacionet fetare, varrezat dhe grafitit fyese duhet të hetohen më fuqishëm;
- Nevojiten më shumë përpjekje për luftimin e mosdurimit ndaj personave LGBTI, meqë shumë prej tyre vazhdojnë të jenë të rrezikuar nga diskriminimi dhe dhuna;

### **Dhuna në bazë gjinore dhe dhuna në familje**

- Duhet të bëhen përpjekje për miratimin e Ligjit të amandamentuar për mbrojtje nga dhuna në familje; në këtë proces duhet të merren parasysh propozimet dhe komentet që vijnë nga akterët relevantë të shoqërisë civile; vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet sigurimit të pozitës dhe qëndrueshmërisë financiare të strehimoreve;
- Të gjitha institucionet përkatëse duhet të kontribuojnë në databazën me rastet e dhunës në familje, siç parashihet; burimet teknike dhe njerëzore të nevojshme për përmbushjen e kësaj detyre duhet të vihen në dispozicion;
- Komunikimi dhe bashkëpunimi mes policisë dhe prokurorisë duhet të përmirësohet;
- Policia duhet të jetë më mirë e trajnuar dhe e pajisur për të patur mundësinë e zbatimit të qasjes gjithëpërfshirëse të bazuar në viktimën gjatë intervistimit të viktimës dhe grumbullimit adekuat të provave teknike;
- Dispozitat e Kodit Penal të ri rreth dhunës në familje duhet të merren plotësisht parasysh nga gjykatat; kjo vlen në veçanti për faktorin rëndues të veprës penale të kryer në ambiente familjare për sigurimin e arsytimit të detajuar për dënimet në të cilat faktorët rëndues kundërpeshohen nga faktorët lehtësues.

## **SHTOJCA II - LISTA E RASTEVE TË MONITORUARA DHE TË REFERUARA**

Pas themelimit të tij në vitin 2008, EULEX-it iu dha një mandat ekzekutiv, që do të thotë se prokurorët dhe gjyqtarët ndërkombëtarë të EULEX-it i drejtonin hetimet, ndjekjet penale dhe gjykimet e rasteve të krimeve të luftës, krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve të tjera të rënda. Që nga muaji qershor i vitit 2018, EULEX-i nuk e kishte më këtë mandat dhe i transferoi lëndët tek autoritetet gjyqësore vendase. Rastet e përmendura në këtë raport, të cilat ishin trajtuar nga EULEX-i gjatë mandatit të tij ekzekutiv, referohen si ish-rastet e EULEX-it.

### **Ish-rastet e EULEX-it**

#### **Rasti Olympus I (PKR 610/2016), i njohur gjithashtu si “Rasti Toka”**

Më 24.10.2016, Prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Azem Sylës dhe të tjerëve. Bëhet fjalë për 22 të pandehur (nga të cilët 17 janë duke u gjykuar pasi katër të pandehur janë në arrati kurse një ndërroi jetë ndërkohë). Rasti ka të bëjë me pronësinë e kundërligjshme të një pjese të madhe të pronës shoqërore në periudhën prej vitit 2006 deri më tani. Grupi pretendohet se ka arritur ta regjistrojë pronësinë e këtyre pronave në dobi të tyre përmes veprimeve korruptive duke i shfrytëzuar personat në pozita kryesore në gjykata, zyrën kadastrale dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Vlera e përgjithshme e llogaritur e tregut e pronave është mbi 25 milion euro. Dy të pandehur janë në paraburgim. Prej muajit nëntor 2018, Gjykata Themelore e Prishtinës mbajti rregullisht seanca deri në mbylljen për shkak të pandemisë COVID 19 në mes të muajit mars 2020.

#### **Rasti Grande (PKR 305/2016)**

Më 16.12.2016, Prokuroria ngriti aktakuzë kundër një grupi prej 20 të pandehurve, (përfshirë Ukë Rugova, djali i ish-Presidentit Rugova) në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Të pandehurit akuzohen për organizim dhe pjesëmarrje në një grup kriminal, kontrabandë me migrantë dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. Në të vërtetë, aktakuza pretendon se të pandehurit kanë përdorë mjete mashtruese për të marrë viza Schengen për qytetarët e Kosovës nga Ambasada e Italisë në Kosovë, duke përfituar kështu fitime të konsiderueshme materiale për veten e tyre. Gjyqtari kryesues e ka ndarë rastin në korrik 2019, në dy raste të ndara, “Grande I” me pesë të pandehur, duke përfshirë Ukë Rugovën dhe “Grande II” me 15 të pandehur. Prej atëherë e tutje, gjykata ka zhvilluar rregullisht seanca për rastin Grande I, deri në mbylljen për shkak të pandemisë COVID 19 në mes të muajit mars 2020. Rasti Grande II ishte mjaft aktiv duke nisur nga janari 2020 deri në mbyllje.

#### **Rasti i arratisjes nga spitali (PKR 685/2016)**

Më 17.11.2016, Prokuroria ngriti akuza pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër të pandehurve Emrush Thaçi, Sami Lushtaku dhe të tjerëve, të cilët janë pjesë e një grupi më të madh të pandehurve të përfshirë në arratisjen nga Spitali Universitar i Prishtinës (QKUK) në maj 2014. Aktakuza i ngarkon njëzet e katër të pandehurit për kryerjen e pretenduar të veprave të ndryshme penale të tilla si Arratisja e personave të privuar nga liria”, “Mundësimi i arratisjes së personave të

privuar nga liria”, “Keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar”, “Lirimi i paligjshëm i personave të privuar nga liria”, “Ofrimi i ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Pengimi i dëshmisë ose procedurës zyrtare”, “Frikësimi gjatë procedurave penale” dhe “Pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal”. Disa herë janë bërë përpjekje për ta mbajtur seancën fillestare por ato u shtynë, në disa prej tyre për shkak të problemeve të pretenduara shëndetësore të pandehurit kryesor Sami Lushtaku. Përpjekja e katërt ishte e suksesshme dhe seanca fillestare më në fund u mbajt më 06.12.2017. Kërkesa nga të pandehurit për ta hedhur poshtë aktakuzën nuk ishte e suksesshme dhe Gjykata e Apelit e konfirmoi aktakuzën më 15.06.2018 dhe e ktheu atë në Gjykatën Themelore të Prishtinës për shqyrtimin gjyqësor. Gjatë gjykimit, në fund të vitit 2019, e pandehura Myrvete Hasani, gruaja e Sami Lushtakut, u deklarua fajtores për “Mundësimin e arratisjes së personave të privuar nga liria në bashkëkryerje” dhe u dënua me gjashtë muaj burgim, i cili më pas u shndërrua në një gjobë prej 3.500 eurosh si pjesë e një marrëveshjeje mbi pranimin e fajësisë. Më 20.02.2020, gjykata duke synuar përshtetimin e procedurës, vendosi t’i ndërpresë procedurat ndaj gjashtë prej të pandehurve Rrukolli, Fatmir Mjaku, Rexhep Xhota, Skender Tahiri, Sheremet Jashari dhe Bajram Dibrani) në lidhje me akuzat për frikësim të dëshmitarëve. Në këtë rast vepra penale “Arratisja e personave të privuar nga liria” për tre të pandehurit kryesorë (Sami Lushtaku, Sahit Jashari dhe Ismet Haxha) do ta arrijë parashkrimin më 23 maj 2020.

### **Rasti Olympia (PKR 236/2017)**

Më 21.07.2017, Prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Alban Dezdari (në paraburgim nga 07.07.2017) dhe Bedri Krasniqi (duke e vuajtur dënimin në një rast tjetër) duke i akuzuar ata për vrasje të rëndë. Ata dyshohet se morën pjesë në vrasjen e një zyrtari policor të UNMIK-ut dhe një zyrtari të Policisë së Kosovës në muajin mars 2004 në Podujevë me katër kryerës të tjerë, përfshirë dëshmitarin Shkumbin Mehmeti, i cili ishte dënuar tashmë me 30 vjet burgim në një gjykim tjetër për këtë vrasje më 09.11.2007. Nga muaji prill 2019, gjykata zhvilloi rregullisht seanca deri në mbylljen për shkak të pandemisë COVID 19 në mes të muajit mars 2020. Që atëherë rasti është joaktiv.

### **Rasti City Club (P 100/2018)**

Më 21.07.2017, Prokuroria ka ngritur aktakuzë kundër Granit Elshanit (në paraburgim që nga tetori 2016) në Gjykatën Themelore të Pejës. Ai akuzohet se në janar 2010, në City Club në Pejë, e ka vrarë një person dhe ka plagosur dy persona, duke përfshirë Valdet Kelmendin, i cili ishte faktikisht caku. Ky sulm u vlerësua si i lidhur me një hakmarrje midis familjeve Elshani dhe Kelmendi, e cila kishte vazhduar për 15 vjet dhe gjatë së cilës ishin vrarë dhjetëra persona nga të dy familjet.

Më 30.05.2018, Gjykata Themelore e Pejës (P 253/2016) dënoi të pandehurin me një dënim unik prej 25 vjet burgim për vrasje të rëndë, tentim vrasje të rëndë, shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe posedim dhe përdorim të paligjshëm të armëve. I pandehuri u ankua kundër aktgjykimit dhe më 16.10.2018, Gjykata e Apelit (PAKR 434/2018) e anuloi aktgjykimin e shkallës së parë. Rigjykimi filloi në janar 2019. Që atëherë gjykata i zhvilloi seanca rregullisht deri në mbylljen për shkak të pandemisë COVID 19 në mes të muajit mars 2020.

**Rasti Emin Krasniqi (PKR 591/2016)**

Më 28.06.2011, Prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën e Qarkut në Prizren (P 176/2011) kundër të pandehurve Emin, Durim, Berat, Astrit dhe Hazir Krasniqi. Ata u akuzuan se ishin përfshirë në një përlëshje me anëtarët e familjes Limaj në një restorant, gjatë së cilës ata dyshohet se i plagosën Azem dhe Ilir Limaj dhe e vranë Skender Limajn. Më 13.08.2012, një trup i përzier me një gjyqtar vendas dhe dy të EULEX-it i shpalli të gjithë të akuzuarit fajtorë dhe e dënoi Emin Krasniqin me 23 vjet burgim, Berat Krasniqin me 7.5 vjet burgim, ndërsa Astrit Krasniqi dhe Hazir Krasniqi u dënuan me nga 2 vjet burgim secili kurse Durim Krasniqi me një vit. Më 24.10.2013, Gjykata e Apelit e anuloi aktgjykimin dhe urdhëroi që paraburgimi të vazhdohej vetëm për Emin dhe Berat Krasniqin. Rigjykimi filloi më 06.02.2014 (P 372/2013). Në këtë rigjykim të parë, Gjykata Themelore e Prizrenit, më 21.04.2016, e shpalli Emin Krasniqin fajtor për “Vrasje e rëndë” dhe e dënoi atë me 22 vjet burgim, ndërsa Hazir Krasniqi u dënua me pesë vjet burgim për “Ndihmë për vrasje të rëndë”. Berat Krasniqi u dënua me tre vjet për “Lëndim të rëndë trupor” dhe “Posedim, mbajtje dhe kontroll i paautorizuar i armëve të zjarrit”. Dy të pandehurit e tjerë u shpallën të pafajshëm. Pas ankesës nga të pandehurit, rasti u kthye mbrapa dhe rigjykimi i dytë filloi më 14.12.2018. I pandehuri kryesor Emin Krasniqi, ka qëndruar në paraburgim për më shumë se tetë vjet, gjë që ngre shqetësime në lidhje me të drejtat e të pandehurit. Në mars të vitit 2019, gjykata e refuzoi kërkesën e tij për ndërprerjen e paraburgimit dhe zëvendësimin e tij me lirim me dorëzani në shumën prej 100,000 euro dhe me paraburgim shtëpiak. Për këtë rast nuk është mbajtur asnjë seancë që kur gjykata urdhëroi një ekspertim të ri në prill 2019.

**Rasti Naser Kelmendi (PKR 32/2019)**

Më 04.07.2014, Prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër Naser Kelmendit për “Krim i organizuar”, “Vrasje e rëndë”, “Posedim, shpërndarje ose shitje e paautorizuar e narkotikëve” dhe “Prodhim dhe përpunim i paautorizuar i narkotikëve”. Më 01.02.2018, gjykata e shpalli të pandehurin fajtor për veprën penale “Posedim, shpërndarje ose shitje e paautorizuar e narkotikëve” dhe e dënoi atë me 6 vjet burgim kurse e liroi nga të gjitha akuzat e tjera. Të dy palët u ankuan kundër këtij vendimi. Më 02.08. 2018, Gjykata e Apelit e dërgoi rastin për rigjykim që kufizohej vetëm në veprën penale “Posedim, shpërndarje ose shitje e paautorizuar e narkotikëve”, e vërtetoi lirimin nga Gjykata Themelore për akuzat e tjera dhe urdhëroi ndërprerjen e paraburgimit të Naser Kelmendit. Më 06.11.2019, më shumë se një vit pas këtij vendimi nga Gjykata e Apelit, u mbajt seanca fillestare e rigjykit kurse seanca e dytë u mbajt më 29.12. 2019. Problemi kryesor për vazhdimin e rastit është mungesa e një përgjigje zyrtare nga Bosnja dhe Hercegovina në lidhje me mundësinë e dëgjimit të një dëshmitari të mbrojtur.

**Rasti Olympus II (PKR 611/2016)**

Më 24.10.2016, Prokuroria ngriti dy aktakuza në Gjykatën Themelore të Prishtinës në lidhje me rastet Olympus I dhe Olympus II në lidhje me një grup të dyshuar të organizuar kriminal që kishin përfituar në mënyrë të paligjshme pronësinë e një pjese të madhe të pronës shoqërore në periudhën prej 2006 deri 2016. Akuzat e aktakuzës për Rastin Olympus II kundër të pandehurve Baki Abdullahu, Hali Hyseni dhe 15 të pandehurve të tjerë janë të kufizuara në «Pastrim parash». Më 03.02.2020, gjykata u përpoq ta mbajë seancën e parë, por kushtet ligjore nuk u përmbushën për shkak të mungesës së pesë të pandehurve, ku njëri prej tyre



dyshohet se jeton jashtë vendit. Seanca e datës 17.03. 2020 u pezullua për shkak të situatës pandemike.

#### **Rasti Toka 4 (PKR 130/2016)**

Më 24.10.2016, Prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër 24 personave, përfshirë gjyqtarë. Rasti ka të bëjë me përfitimin e paligjshëm të pronësisë mbi një pjesë të madhe të tokës në pronësi shoqërore. Akuzat janë për krim të organizuar, pastrim të parave, lëshim i vendimeve të paligjshme gjyqësore dhe keqpërdorim i pozitës zyrtare në lidhje me reregjistrimin e tokës në pronësi shoqërore. Më 26.10. 2017, u mbajt seanca fillestare e parë e pasuar nga dy seanca të tjera në prill dhe maj 2019. Rasti tani është në fazën e shqyrtimit kryesor, megjithatë, asnjë seancë nuk është caktuar deri më sot.

#### **Rasti Medicus (PKR 315/2018)**

Më 15.10.2010 dhe më 20.10.2010, Prokuroria ngriti dy aktakuza në Gjykatën Themelore të Prishtinës (e bashkuar në një të vetme në nëntor 2010) kundër shtatë personave me pretendimet për trafikim të organeve njerëzore, krim të organizuar dhe krime të tjera të rënda. Akuza pretendon se, gjatë vitit 2008, në Klinikën Medicus u bënë dhjetëra transplantime të paligjshme të veshkave. Të pandehurit kryesorë ishin urologu Lutfi Dervishi, i cili ishte pronar i klinikës dhe djali i tij, Arban Dervishi, i cili e menaxhonte atë. Më 29.04.2013, Gjykata Themelore e Prishtinës (trupi gjykues me shumicë nga EULEX-it, d.m.th. shumica e gjyqtarëve në trupin gjykues ishin gjyqtarë ndërkombëtarë të EULEX-it) i shpalli të pandehurit fajtorë për trafikim të personave dhe krim të organizuar dhe i dënoi ata me burgim prej tetë vjetësh (Lutfi Dervishi) dhe shtatë vjet e tre muaj (Arban Dervishi). Një tjetër i pandehur në këtë rast, Sokol Hajdini, krye-anesteziologu i klinikës, u dënua me burgim prej tre vjetësh. Më 06.11.2015, Gjykata e Apelit (trupi gjykues me shumicë nga EULEX-i) e konfirmoi aktgjykimin.

Më 08.03.2016, Arban Dervishi dhe më 05.04.2016, Lutfi Dervishi paraqitën kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Më 07.03 2016, Sokol Hajdini gjithashtu paraqiti ankesë kundër aktgjykimin të njëjtë të Gjykatës së Apelit.

Më 20.09.2016, Gjykata Supreme (trupi gjykues me shumicë nga EULEX-i), e liroi të pandehurin Sokol Hajdini nga akuza për krim të organizuar dhe e shpalli atë fajtor për veprën penale të dëmtimit të rëndë trupor. Më 15.12.2016, Gjykata Supreme, tani me një trup gjykues të përbërë nga shumica e gjykatësve vendas, nxori vendimin për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga Arban dhe Lutfi Dervishi me votat dy me një, ku dy gjyqtarët Kosovarë ishin shumicë ndërsa gjyqtari i EULEX-it ishte kundër. Vendimi i tyre e anuloi dënimet në lidhje me Lutfi dhe Arban Dervishi dhe Sokol Hajdini dhe e ktheu rastin në Gjykatën Themelore për rigjykim. Të pandehurit e tjerë ishin liruar ose akuzat ishin hedhur (vendimi i Gjykatës së Apelit i 06.11.2015). Më 11.01.2017, Gjykata Themelore e Prishtinës caktoi paraburgimin ndaj Lutfi Dervishi dhe lëshoi një fletërreshtim ndërkombëtar kundër Arban Dervishit, i cili ishte në arrati.

Më 24.05.2018, Gjykata Themelore e Prishtinës (trupi gjykues me shumicë nga EULEX-i) e shpalli Lutfi Dervishin fajtor për trafikim të personave dhe krim të organizuar dhe i shqiptoi një dënim prej shtatë vjet e gjashtë muaj, një gjobë prej 8.000 euro, dhe ndalim të ushtrimit

të profesionit të urologut për periudhën dy vjeçare duke filluar nga dita e mbajtjes së plotë të dënimit me burg. Sokol Hajdini u shpall fajtor për lëndim të rëndë trupor dhe u dënua me një vit burgim. Më 06.11.2018, Gjykata e Apelit (të gjithë gjyqtarët vendas), duke vendosur mbi ankesat e të pandehurve Lutfi Dervishi dhe Sokol Hajdini kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PKR 11/2017) të datës 24.05.2018, e anuloi aktgjykimin dhe e dërgoi rastin përsëri në rigjykim të dytë. Gjykata megjithatë vendosi që Lutfi Dervishi duhej të qëndronte në paraburgim pasi arsyet për të nuk kishin pushuar së ekzistuari. Aktgjykimi për Sokol Hajdinin ishte anuluar pasi vepra kishte arritur parashkrimin absolut. Arban Dervishi, i cili ishte fshehur jashtë Kosovës, arriti një marrëveshje me autoritetet gjatë vitit 2019, gjatë të cilit ai u kthye në Kosovë dhe nga ana tjetër, fletreshtimi ndërkombëtar kundër tij u pezullua. Aktualisht rasti është në rigjykimin e dytë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër të pandehurve Lutfi dhe Arban Dervishi. Seanca e radhës ishte caktuar për 27.10.2020.

### **Rasti Touareg (P 176/2015)**

Më 23.10.2015, Prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kundër tre vëllezërve Albert, Mentor dhe Arianit Beqiri dhe Vesat Imeri, duke i akuzuar ata për evazion fiskal në vlerë prej rreth 1.69 milion euro. Midis viteve 2011 dhe 2012, vëllezërit, pronarë të biznesit NTP Oil Kosova, dyshohet se kishin ofruar informacion të rremë në Administratën Tatimore në lidhje me të ardhurat e krijuara nga biznesi i tyre në mënyrë që të shmangnin pjesërisht ose plotësisht pagesën e taksave, tarifave ose kontributeve të parapara me ligj. Në kuadër të këtij konteksti, të katër të pandehurit dyshohet se ishin përfshirë në pastrim parash. Ky rast është joaktiv që nga korriku 2017, pasi kërkesa e palëve për ta hedhur poshtë aktakuzën u refuzua nga Gjykata Themelore.

### **Rasti KEK (PKR 18/2015)**

Më 10.01.2015, Prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Prishtinës kundër shtatë të pandehurve, përfshirë ish kryetarin e Skenderajt Sami Lushtaku. Të pandehurit u akuzuan mbi pretendimet për kryerjen e veprës penale të “Keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autoritetit”, “Mashttrim”, “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Lidhja e kontratave të dëmshme”. Kryerja e pretenduar e veprave penale të përmendura çoi në dhënien e paligjshme të tenderëve për shërbime një kompanie të lidhur me Sami Lushtakun, duke i shkaktuar kështu KEK-ut një dëm të përgjithshëm prej 6,182,609.76 euro. Shqyrtimi kryesor u zvarrit në mënyrë të konsiderueshme për shkak të mungesës së Sami Lushtakut, gjoja për arsye mjekësore. Më 20.05.2019, trupi gjykues kryesor shpalli vendimin, duke i liruar të gjithë të pandehurit për akuzat e ngritura kundër tyre në aktakuzë. Më 30.09.2019, Prokuroria u ankua kundër vendimit të Gjykatës Themelore. Vendimi i Gjykatës së Apelit është ende në pritje.

### **Ish-rastet e krimeve të luftës të EULEX-it**

#### **Rasti Drenica I (PKR 74/2018)**

Më 06.11.2013, Prokuroria ngriti aktakuzë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës kundër shtatë të pandehurve të akuzuar për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullatës civile midis qershorit dhe shtatorit 1998 në lidhje me Qendrën e Paraburgimit të UÇK-së

në Likoc në Skenderaj. Më 27.05.2015, gjykata e shkallës së parë i liroi të pandehurit Sabit Geci, Ismet Haxha, Sahit Jashari dhe Avni Zabeli, gjë që u confirmua në shkallën e dytë nga Gjykata e Apelit më 15.09.2016. Sami Lushtaku u shpall fajtor në gjykimin e shkallës së parë për vrasje të rëndë dhe përgjegjësi komanduese për shkeljen e integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të pidentifikuar civilësh dhe u ankua kundër këtij aktgjykimi. Ai u lirua nga akuzat për vrasje në shkallë të dytë me aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Apelit të datës 15.09.2016. Më vonë, së bashku me Sylejman Selimin, ai u lirua gjithashtu nga akuza e mbetur për «Përgjegjësi komanduese» me vendim të Gjykatës Supreme të datës 03.07. 2017, pas së cilës ai u la i lirë. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme në çështjen Drenica I e konfirmoi dënimin nga Gjykata e Apelit i datës 15.09.2016 të Jahir Demakut (i cili në shkallën e parë ishte shpallur i pafajshëm, por pas ankesës nga prokuroria u shpall fajtor nga Gjykata e Apelit) dhe të Sylejman Selimit për “Shkelje e integritetit trupor dhe shëndetit” të një mashkulli të pidentifikuar nga zona e Shipolit në Mitrovicë duke e rrahur vazhdimisht. Më 11.06. 2018, Gjykata Supreme e dërgoi rastin për rigjykim në Gjykatën Themelore të Mitrovicës (pasi vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 07.06. 2018 e kishte rrëzuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të datës 19.07. 2017 në lidhje me çështjen Drenica II dhe e kishte dërguar atë për rishqyrtim) dhe të dy të pandehurit e dënuar u lanë të lirë nga vuajtja e dënimit. Sidoqoftë, të dy Jahir Demaku dhe Sylejman Selimi mbetën në burg për ta vuajtur dënimin e shqiptuar në lidhje me vendimin Drenica II, derisa ata u liruan me kusht me vendimet e Panelit për Lirim me Kusht të datave 24.10. 2018 dhe 25.01. 2019. Pas krijimit të Departamentit Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Gjykata Themelore e Mitrovicës e dërgoi rastin në Departamentin Special në Gjykatën Themelore të Prishtinës, duke konsideruar se ai nuk ishte më nën juridiksionin e saj. Në prill 2019, Departamenti Special e ktheu çështjen në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, duke argumentuar se Gjykata Themelore e Mitrovicës tashmë kishte filluar gjykimin e kësaj çështje dhe prandaj duhej ta përfundonte atë. Më 06.11.2019, u caktuan dy anëtarë të trupit gjykues në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, por seanca fillestare e caktuar për 26.12.2019 u shty për 25.03.2020 me kërkesë të prokurorit. Për shkak të kufizimeve të lidhura me pandeminë, seanca dëgjimore e 25 marsit nuk u mbajt.

### **Rasti Zlatan Krstić/Destan Shabanaj (PPS 17/2019)**

Në dhjetor të vitit 2019, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës për një sërë akuzash kundës Zlatan Krstić dhe Destan Shabanaj, që të dy pjesëtarë të policisë serbe gjatë luftës në Kosovë. Zlatan Krstić u akuzua për shkeljen e rregullave të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare (Konventa e Gjenevës). Pretendimet ishin se, më 26 mars 1999, në një fshat në komunën e Ferizajt, duke e ditur dhe me qëllim, duke vepruar sipas planit dhe urdhrave të eprorëve të tij, ai mori pjesë drejtpërdrejtë në një sulm kundër popullatës civile. Pretendohet se i pandehuri mori pjesë në keqtrajtimin e rëndë të anëtarëve të familjes Nuha, i largoi ata me dhunë nga shtëpia e tyre, i trajtoi në mënyrë çnjerëzore, mori pjesë në shkatërrimin e paligjshëm dhe me qëllim të pronës së familjes, dëbimin e 15 anëtarëve të familjes dhe në marrjen peng të katër personave dhe kontribuoi në mënyrë domethënëse në trajtimin mizor, torturimin, gjymtimin dhe në fund vrasjen e tyre. Destan Shabanaj u akuzua për shkeljen e rregullave të së drejtës humanitare ndërkombëtare kundër civilëve. Më 01.04.1999, pretendohet se ai urdhëroi që trupat e viktimave të luftës të varroseshin pa dinjitet dhe në kundërshtim me rregullat e luftës duke i urdhëruar pjesëtarët e policisë që trupat t'i zhvendosnin nga morgu i Prishtinës dhe që ata të hidheshin në një varr masiv të pashënuar.

Aktakuza u konfirmua nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe gjykimi i shkallës së parë është aktualisht në fazë të intervistimit të dëshmitarëve.

### **Rasti Nenad Arsić (PPS 01/2016)**

Në dhjetor 2019, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër Nenad Arsić duke e akuzuar atë për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullatës civile gjersa ishte duke shërbyer si pjesëtar i policisë serbe gjatë luftës në Kosovë. Më 21.05.1999, i pandehuri pretendohet se ka marrë pjesë në një operacion kundër civilëve, qëllimisht ka vepruar në mënyrë çnjerëzore dhe ka cenuar integritetin fizik dhe mendor dhe mirëqenien e Jakup dhe Skender Shalës duke i rrahur ata për një kohë të gjatë me mjete të forta dhe duke u shkaktuar lëndime trupore të rënda, duke e fyer dhe poshtëruar Jakup Shalën dhe duke e nënshtruar atë në trajtim çnjerëzor.

Aktakuza u konfirmua nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe gjykimi i shkallës së parë aktualisht është në fazë të intervistimit të dëshmitarëve.

### **Rasti Goran Stanišić (PPS 14/2018)**

Në shkurt 2020, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër Goran Stanišić duke e akuzuar atë për krime luftime të kryera gjatë luftës në Kosovë kundër popullatës civile. Në prill 1999, i pandehuri pretendohet se ka marrë pjesë në një sulm të gjerë të policisë, dhe forcave militare dhe paramilitare serbe në dy fshatra në Komunën e Lipjanit dhe në depërtimin dhe vrasjen e civilëve.

Aktakuza u konfirmua nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe gjykimi i shkallës së parë aktualisht është në fazë të intervistimit të dëshmitarëve.

### **Rasti Darko Tasić (PKR 35/2018)**

Më 26.04.2018, Prokuroria ngriti aktakuzë kundër Darko Tasić pranë Gjykatës Themelore të Prizrenit. Akuzat kishin të bënin me dy incidente në mars 1999, në të cilat i pandehuri pretendohet se ka marrë pjesë në plaçkitje, vjedhje dhe shkatërrim të pronës, sulm të rëndë dhe mizori në një fshat në Komunën e Prizrenit dhe, pas dy dite, ka kryer veprën penale të përdhosjes së trupave të pajetë. I pandehuri kishte shërbyer në forcën policore jugosllave dhe pretendohet se ka kryer krimet në bashkëkryerje me të tjerët.

Më 22 qershor 2020, gjykata e shkallës së parë shpalli aktgjykimin e saj dhe shqiptoi një dënim prej 22 viteve burgim, që tejkalon maksimumin e përshkruar me ligj. Akgjykimi i shkruar nuk e ka dhënë arsyetimin e nevojshëm për këtë tejkalim. I pandehuri ka bërë ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit, e cila pritet ose të zbutë dënimin ose të kthej rastin në Gjykatën Themelore për rigjykim.

### **Rasti Remzi Shala (P 181/2016), i njohur edhe si “Rasti Mollakuqe”**

Në tetor 2016, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prizrenit kundër Remzi Shalës për krim të luftës kundër popullatës civile. I pandehuri kishte qenë pjesëtar i UÇK-së dhe siç pretendohet, së bashku me 5 – 6 pjesëtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK-së, ka rrëmbyer dhe vrrarë Haxhi Perteshin më 26.06.1998.

Më 03.07.2019, gjykata e shpalli të pandehurin fajtor për veprën penale të krimeve të luftës kundër civilëve dhe e dënoi atë me 14 vite burgim. I pandehuri parashtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit.

Më 26.11.2019, Gjykata e Apelit pjesërisht miratoi ankesën dhe e ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe e dënoi të pandehurin me 10 vite burgim për kryerje të krimeve të luftës kundër civilëve. Pjesa tjetër e aktgjykimit mbeti e pandryshuar, ndërsa ankesa e palës së dëmtuar u refuzua si e pabazuar.

Avokati i të pandehurit parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtij vendimi në bazë të shkeljes së të drejtës penale dhe shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës penale. Më 02.03.2020, Gjykata Supreme vendosi sipas kërkesës dhe i anuloi të dy vendimet dhe e ktheu rastin për rigjykim në Gjykatën Themelore të Prizrenit, ku gjykimi është aktualisht në proces.

## **Rastet që nuk kanë qenë të EULEX-it**

### **Rasti Gani Rama dhe Pal Lekaj (PKR 64/2018)**

Më 26.05.2016, Prokuroria ngriti aktakuzë kundër Gani Ramës pranë Gjykatës Themelore të Gjakovës. Në cilësinë e tij si zyrtar i Komunës së Gjakovës gjatë periudhës 2008-2012, i pandehuri pretendohet se ka tejkalluar autorizimet e tij zyrtare në lidhje me subvencionet dhe prokurimin për 'përfitime të tij apo personave të tjerë, duke i shkaktuar dëme buxhetit komunal që arrinin gjithsej 218,956.67 euro. Më 13.02.2017, Gjykata Themelore e liroi të akuzuarin nga akuza me arsyetimin se nuk ishte e mundur të dëshmohej se ai e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej. Ky vendim u apelua nga Prokuroria dhe Gjykata e Apelit e ktheu rastin për rigjykim në Gjykatën Themelore. Më 09.02.2018, Gjykata Themelore e Gjakovës prapë e liroi të pandehurin nga akuza, me arsyetimin e njëjtë si në gjykimin e parë. Prokuroria apeloj prapë dhe më 01.11.2018, Gjykata e Apelit e miratoi ankesën dhe e ktheu rastin në Gjykatën Themelore për një rigjykim të dytë, duke u arsyetuar se gjykata e shkallës së parë e kishte bazuar gjykimin e saj tërësisht në opinionin e ekspertit financiar, i cili nuk kishte dhënë opinion të qartë dhe konkret në lidhje me pozitën e mbajtur dhe kompetencat e ushtruara nga i pandehuri në kohën e kryerjes së veprave të pretenduara. Më 07.11.2019, filloi rigjykimi i dytë në Gjykatën Themelore të Gjakovës, pasi që gjykata e kishte bashkuar rastin me rastin kundër ish-kryetarit të Gjakovës, Pal Lekaj dhe të tjerët. (PKR 16/2018), të cilët po ashtu ishin akuzuar kryesisht për veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. Që nga fillimi i gjykimin që tani është bashkuar, janë mbajtur seanca të rregullta deri në kufizimet e ndërlydhura me COVID 19 në mesin e muajit mars 2020.

### **Rasti Veteranët (PKR 230/2018)**

Në shtator 2018, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër 12 personave në rastin që për publikun njihet si "Veteranët", me akuza të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. Të pandehurit ishin Agim Çeku, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaga, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari. Ata u akuzuan se ua mundësuan rreth 20.000 personave marrjen e pensioneve të veteranëve në bazë të pohimeve të rreme për anëtarësi në pjesëmarrje

në UÇK, duke i shkaktuar kështu buxhetit të Kosovës dëm prej 68,153,533.14 euro. Prokurori Elez Blakaj, i cili e hartoi aktakuzën, lëshoi Kosovën në gusht të vitit 2018, siç pretendohet për shkak të kërcënimeve që i ishin bërë. Gjykimi kryesor është në proces, ndërsa një sere seancash gjyqësore janë anuluar për shkak të situatës me pandeminë.

### **Rasti Pronto (PKR 90/2018)**

Më 06.04.2018, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës me akuza të “Shkeljes së statusit të barabartë të qytetarëve dhe banorëve të Kosovës” kundër 11 të pandehurve, përfshirë disa zyrtarë të nivelit të lartë, si ish-deputetët e Kuvendit të Kosovës Adem Grabovci dhe Zenun Pajaziti dhe ish-ministri Besim Beqaj. Seanca dëgjimore fillestare është mbajtur më 15.11.2018. Më 31.05.2019, Gjykata e Apelit e konfirmoi aktakuzën, pas parashtrimit të ankesave nga të gjithë të pandehurit. Gjatë procedurës gjyqësore ndodhën një sërë përplasjesh mes prokurorit dhe kryetarit të trupit gjykues. Seanca e fundit dëgjimore me fjalën përmbyllëse u mbajt më 30.12.2019 dhe 03.01.2020, të gjithë të pandehurit u liruan nga akuza meqë gjykata konsideroi se nuk ishte dëshmuar që të akuzuarit i kishin kryer veprat për të cilat akuzoheshin. Prokuroria e ankimoi aktgjykimin në mars të ketij viti.

### **Rasti Syri i Popullit (PKR 46/2018)**

Më 27.02.2018, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër Sadri Ramabajës, Murat Jasharit, Ragip Sallovës, Avni Llumnicës, Sabit Berishës, Bexhet Luzhës, Halim Halimit, Bajrush Konjushës, Lirije Luzhës dhe Rexhep Topllanës. Ata u akuzuan për vepra të hakmarrjes, përgatitjes së veprave terroriste apo kriminale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, tentimvrasjes së rëndë dhe vepra të tjera penale. Ky grup pretendohet se ka nxjerrë një listë të shqiptarëve të Kosovës të cilët duhet të ekzekutohen si tradhtarë. Ish-zyrtari komunist i nivelit të lartë, Azem Vllasi, i mbijetoi një përpjekje të vrasjes nga pjesëtari i pretenduar i grupit, Murat Jashari, në mars 2017. Tre të pandehur gjenden në paraburgim, ndërsa një është në arrest shtëpiak. I pandehuri Jashari gjendet në paraburgim në objektin mjekësor për shkak të sëmundjes së tij të rëndë mendore. Në janar 2020, me përjashtim të dy të pandehurve, të gjithë të tjerët ishin shpallur fajtorë. Të pandehurve kryesorë iu shqiptuan dënimet me burgim si në vijim: Avni Llumnica 12 vite; Sadri Ramabaja 5 vite; Murat Jashari 10 vite. Gjykimi i shkallës së parë është përfunduar ndërsa procedura e animimit është në pritje të ankesave të parashtruara nga të pandehurit e shpallur fajtorë nga Gjykata Themelore.

### **Rasti 3 % (P 2022/2017)**

Më 28.4.2017, Prokuroria ngriti aktakuzë kundër Bujar Bukoshit, Naser Osmanit dhe Atdhe Gashit. Të pandehurit pretendohet se kanë keqëpërdorur para që ndërlidheshin me buxhetin e “donacioneve 3%” (kontribut vullnetar, kryesisht nga diaspora kosovare për mbështetjen e Kosovës gjatë viteve 1990-ta) për Kosovën gjatë periudhës 2006-2015 (Bujar Bukoshi pretendohet se ka përvetësuar rreth 91.000 euro; Naser Osmani dhe Atdhe Gashi pretendohet se së bashku kanë përvetësuar rreth 154.000 euro). Më 30.11.2018, Prokuroria, pas një kërkesë nga gjykata, e ndryshoi aktakuzën duke prezantuar sqarime shtesë rreth çështjes së fakteve në lidhje me Bujar Bukoshin. Rasti kundër Bujar Bukoshit pastaj u veçua për shkak të një gjendje të rëndë mjekësore, meqë ai është duke u trajtue jashtë vendit. Më 03.12.2018, gjykata hodhi poshtë kërkesën e Naser Osmanit dhe Atdhe Gashit për hedhjen poshtë të aktakuzës. Gjykata

e Apelit i refuzoi ankesat e tyre më 17.01.2019. Më 15.08.2019, gjykimi filloi me seanca të rregullta deri në fund të muajit tetor 2019. Që atëherë, nuk është mbajtur asnjë seancë në pritje të opinionit të kërkuar të ekspertit.

### **Rasti Transporti (PKR 147/2016)**

Më 30.11.2016, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Mitrovicës kundër 21 të pandehurve të akuzuar për udhëheqësi dhe pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal, për shmangie të pagesave të detyrueshme të taksave doganore, kontrabandim të mallrave (kryesisht karburante dhe cigare mes Kosovës dhe Serbisë), tregti të ndaluar, dhe evazion tatimor, të gjitha në bashkë-kryerje. Shtatë prej 21 të pandehurve po ashtu u akuzuan për posedim të paligjshëm të armëve. Disa prej të pandehurve janë pronarë të pompave të derivateve në veri të Kosovës. Gjykimi kryesor filloi në mesin e vitit 2018. Që atëherë ka parë vonesa të gjata. Është urdhëruar një raport i ekspertizës për të përcaktuar shumën e dëmeve bërë buxhetit të shtetit. Aktualisht, gjykimi kryesor është në fazë të prezantimit të provave.

### **Rasti Pal Lekaj (P 4668/2018)**

Më 22.02.2016, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër Pal Lekajt dhe pesë të pandehurve të tjerë për veprën penale të posedimit/përdorimit të paautorizuar të armëve dhe pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre. Akuzat kanë të bëjnë me përdorimin e gazit lotsjellës gjatë një seance plenare të Kuvendit të Kosovës dhe pengimit pasues të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre në Kuvend më 14.12. 2015. Rasti më vonë u transferua nga Departamenti për Krime të Rënda (më parë PKR 108/2016) në Gjykatën Themelore tek Departamenti i Përgjithshëm (P 4668/2018) dhe deri më tani nuk është shënuar asnjë aktivitet.

### **Frashër Krasniqi dhe të tjerët (PKR 70/2018), i njohur edhe si „Rasti Gazi lotsjellës”**

Në dhjetor të vitit 2016, Prokuroria ngriti aktakuzë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës kundër Frashër Krasniqit, Atdhe Arifit, Egzon Halitit dhe Adea Batushas. Ata u akuzuan për terrorizëm në lidhje me sulmin me një minahedhës RPG ndaj Kuvendit të Kosovës më 04.08.2016, çka i shkaktoi dëme ndërtesës dhe veturave të parkuara në afërsi. Më 17.11.2017, gjykata i shpalli të pandehurit fajtorë për bashkëkryerje të veprës penale të terrorizmit dhe i dënoi ata me burgim që shtrihet prej dy deri në tetë vite. Pas animimit nga të gjitha palët (të pandehurit si dhe prokuroria), Gjykata e Apelit, më 26.02.2018, e anuloi aktgjykimin dhe e ktheu rastin për rigjykim. Më 04.03.2020, seanca e parë e rigjyimit për këtë rast u deshtë të shtyhej menjëherë, meqë mbrojtja, Tomë Gashi, kërkoi diskualifikimin e kryetarit të trupit gjykues, duke pretenduar se ai ishte i anshëm. Ai e arsyetoi këtë kryesisht duke iu referuar gjykimin të shkallës së parë, gjatë së cilit kryetari i trupit gjykues pretendohet se “qëllimisht apo aksidentalisht” nuk ka marrë parasysh prova shfajësuese. Një javë më vonë, Gjykata Themelore e refuzoi atë kërkesë. Rasti tani është në pritje për një fillim të ri.



 [www.eulex-kosovo.eu](http://www.eulex-kosovo.eu)

 [@eulex.kosovo](https://www.facebook.com/eulex.kosovo)

 [@eulexkosovo](https://twitter.com/eulexkosovo)

 [eulexkosovo](https://www.youtube.com/eulexkosovo)